



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 659 Akti

Nr. 684 Vendimi  
Tiranë, më 12.7.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 6.7.2023, ora 13:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ndrichim Troplini**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i pranishëm në seancë dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Ndrichim Troplini është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.

2. Me vendimin e trupit gjykues datë 15.1.2021 është vendosur kryesuese komisionere Firdes Shuli, si dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, e deklaruar për hetim të mëtejshëm, adresë në të cilën iu dërgua pyetësori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.

5. Në datën 12.6.2023, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ndriçim Troplini, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e tij.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Ai paraqiti brenda afatit të përcaktuar shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.

7. Trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/201, ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Ndriçim Troplini, për t'u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 6.7.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 6.7.2023, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit në këtë seancë u paraqit personalisht, si dhe deklaroi se do të mbrohej edhe nga përfaqësuesja, av. A. S., me nr. \*\*\* licence. Gjatë kësaj seance subjekti dhe përfaqësuesja e tij parashtruan qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit.

9. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Ndriçim Troplini në seancën e datës 12.7.2023, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë në tërësi sipas bindjes së tyre të brendshme çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera

**13.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- ë) denoncimet nga publiku;
- f) informacione nga burime të hapura.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**14. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:**

**1. Pasuria automjet tip “\*\*\*\*”,** me targë \*\*\*, vit prodhimi 1988, blerë me Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2005, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë dhe shitur me Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.6.2012, në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit në deklaratën *Vetting*.

**1.1** DPSHTRR-ja informon<sup>2</sup> Komisionin se automjeti tip “Mercedes-Benz 250 D”, vit prodhimi 1988, ka qenë i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit:

- i) Sipas akteve të administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2005, nga pala shitëse, shtetasi S. M. (i përfaqësuar nga shtetasi K. D.), me çmimin 800.000 (tetëqind mijë) lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Lidhur me origjinën e krijimit rezulton se ky automjet është importuar nga shteti italian në vitin 2001 dhe ka ndryshuar pronësinë disa herë deri në vitin 2005 kur i është shitur subjektit të rivlerësimit.
- ii) Sipas akteve të administruara në DPSHTRR, rezulton se ky automjet i është shitur nga subjekti i rivlerësimit me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.6.2012, shtetasit A. Xh. në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**1.2** Lidhur me blerjen e automjetit në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit standard se në momentin e përpilimit të kontratës i ka dhënë palës shitëse shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe diferenca e çmimit të blerjes prej 300.000 (treqind mijë) lekësh është likuiduar në muajt janar ose shkurt 2006, për arsye se automjeti ishte i përdorur dhe do të shikonte ecurinë e tij.

**1.2.1** Referuar përmbajtjes së Kontratës Noteriale të Shitblerjes së vitit 2005, citohet përkatësisht: *“Unë, blerësi, deklaroj se jam dakord të blej mjetin e mësipërm, e kam parë dhe pëlqyer në gjendjen në të cilën ndodhet, kam rënë dakord me çmimin 800.000 (tetëqind mijë) lekë, të cilin e kam likuiduar dhe kam marrë në dorëzim mjetin pa pretendim”.*

*ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.*

<sup>2</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021.

**1.3** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit për periudhën janar - maj 2005, duke marrë në konsideratë të ardhurat nga paga, si dhe shpenzimet përkatëse të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë, nga e cila rezulton se ai nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

Analiza financiare datë 7.5.2005	Vlera në lekë
<b>Blerë automjet tip “****”</b>	<b>800.000</b>
Shtesë likuiditetesh bankare	6.169
<b>Të ardhurat të dokumentuara nga paga</b>	<b>357.331</b>
<b>Total shpenzime</b>	<b>82.315</b>
Shpenzime jetese 1 person	45.649
Shpenzime TIMS	-
Shpenzime udhëtimi për në vendin e punës (Dr - Fr)	36.667
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-531.153</b>

#### **1.4 Në përfundim:**

- i) Rezulton se automjeti tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1988, ka qenë i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit deri në datën 31.12.2017, kur është aplikuar për çregjistrim të përhershëm të automjetit.
- ii) Duket se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në shumën -531.153 (pesëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë për blerjen e automjetit 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vitin 2005.

#### **1.5 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**1.6** Në vijim të barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar me prapësimet e tij: *“Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit për periudhën janar - maj 2005, duke marrë në konsideratë të ardhurat nga paga, si dhe shpenzimet në këtë periudhë dhe nga kjo analizë sipas Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë. Nga vetë analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton se mundësia kumulative për kursim në fund të vitit 2004 është në shumën 781.628 (shtatëqind e tetëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë. Në asnjë vit në DPV-të vjetore nuk është deklaruar gjendje apo shtim likuiditeti cash apo ndonjë pasuri tjetër, por është jologjike të mendohet që në fund të datës 31.12.2004 të kem pasur 0 (zero) lekë kursime cash. Nëse do të marrim në konsideratë edhe të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, atëherë mundësia kumulative për kursim shkon në fund të vitit 2004 në shumën 1.181.281 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekë.*

*Duhet të kihet parasysh në këtë moment se unë kam deklaruar për herë të parë pasurinë për vitin 2004, në muajin mars të vitit 2005 dhe, duke qenë se ka qenë deklarata e parë e pasurisë që kam plotësuar, nuk kam qenë shumë mirë i informuar për mënyrën e deklarimit të likuiditetit cash. Në këtë deklaratë unë kam deklaruar 0 (zero) lekë kursime.*

*Në kushtet kur gabimi në mosdeklarimin e kursimeve është kryer nga ana ime në deklaratën e parë të pasurisë dhe në kushtet kur unë kam pasur mundësi të kursej me të ardhura të ligjshme nga puna dhe bursa në Shkollën e Magjistraturës shumën 1.181.281 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e një) lekë, duke parë edhe diferencën negative të të gjithë vitit 2005, sipas analizës së përgatitur nga Komisioni, vlerësoj se provohet mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për blerjen e parë të pasurisë nga ana ime. Nga sa më sipër, rezulton se kam pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2005 dhe kam vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të njoftuara nga Komisioni si barrë prove për këtë pasuri”.*

**1.7 Në përfundim,** trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e dhëna prej tij gjatë hetimit, vlerëson se nuk mund të pranojë shpjegimet lidhur me gjendje të mundshme cash si rrjedhojë e një analize

hipotetike, për sa kohë që nuk gjenden gjurmë në deklarin periodik vjetor të vitit 2004 apo ndonjë gjendje në bankë. Edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2011 nuk gjenden të dhëna që ta justifikojnë këtë deklarin të subjektit, dhënë pas dërgimit të barrës së provës. Lidhur me deklarimet e tij se pagesat janë bërë me këste përgjatë vitit 2005 – 2006 nuk mund të pranohen pasi ato vijnë ndesh me vetë deklarimet e bëra në kontratë<sup>3</sup> nga palët e nuk gjejnë pasqyrim në ndonjë dokument apo deklarin ndër vite. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 për krijimin e kësaj pasurie.

**2. Pasuria automjet tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2006, me targë \*\*\*, blerë me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.2.2012, në shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Subjekti nuk ka deklaruar burim për krijimin e saj në deklaratën *Vetting*.**

**2.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2011 blerjen e këtij automjeti me Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.2.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e blerjes së këtij automjeti në DPV.

**2.2** DPSHTRR-ja informon<sup>4</sup> për Komisionin se automjeti me targë \*\*\*, vit prodhimi 2006, ka qenë i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit nga data 20.2.2012. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton:

**2.2.1** Automjeti tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2006, figuron se është blerë nga shtetasi D. L. në shtetin gjerman në datën 26.1.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Ky automjet ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datën 18.2.2012 nëpërmjet Portit Detar Durrës dhe shpenzimet doganore janë llogaritur në vlerën 211.041 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë mbi vlerën statistikore për automjetet e kësaj kategorie në shumën 1.055.211 (një milion e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë.

**2.2.2** Subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “\*\*\*\*”, me targë të huaj me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.2.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, ekuivalent në shumën 838.320 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë. Nëse merret në konsideratë se shpenzimet doganore janë paguar nga subjekti i rivlerësimit, kostoja totale e blerjes së këtij automjeti është në vlerën 1.049.361 (një milion e dyzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

**2.3** Duket se ky automjet është importuar nga Gjermania qysh prej fillimit me blerës final subjektin e rivlerësimit dhe se çmimi i blerjes së këtij automjeti sipas kontratës së shitblerjes është më i ulët se vlera statistikore e tij, por shpenzimet doganore në vlerën 211.400 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë janë llogaritur në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

**2.4** Në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhur me burimin e përdorur për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” se: “*Në muajin shkurt 2012 një i afërmi im, shtetasi D. L., ka sjellë një autoveturë tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2006. Në bisedë e sipër me këtë shtetas, të dy me njëri-tjetrin kemi shprehur pëlqimin për të ndërruar automjetet. Nga interesimi në DPSHTRR Durrës, kontrata e shkëmbimit nuk aplikohet dhe duhet të kryenim shitjen e ndërsjellë. Kështu, kemi kryer përpara noterit shitjen me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Pas disa muajsh shtetasi D. L. ka nxjerrë pretendime në lidhje me një defekt në motor që kishte pasur automjeti tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*. Me Kontratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.6.2012, kemi bërë revokimin e Kontratës së Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.2012. Duke qenë se unë e mbajta dhe nuk ia ktheva automjetin tip “\*\*\*\*”, i kam dhënë shtetasit D. L. shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro si çmim për blerjen e autoveturës. Diferenca midis çmimit të shitjes së*

<sup>3</sup> Kontrata e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.5.2005.

<sup>4</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021.

*autoveturës tip “\*\*\*\*” prej 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh dhe blerjes së autoveturës tip “\*\*\*\*” prej 6.000 (gjashtë mijë) euro (6.000 euro - 450.000 lekë) = 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë janë përballuar nga të ardhurat e pagesës time si prokuror”.*

## **2.5** Nga verifikimi i akteve rezulton:

- i) Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.2012, me palë blerëse shtetasin D. L., me objekt shitjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, çmimi i së cilës është likuiduar cash jashtë zyrës noteriale.
- ii) Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.2.2012, me palë shitëse shtetasin D. L., me objekt blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro nga subjekti i rivlerësimit.
- iii) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.6.2012, me objekt revokimin e Kontratës së Shitblerjes së datës 16.2.2012 për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” dhe se palët deklarojnë se çdo gjë kthehet në gjendjen e mëparshme si automjeti edhe të hollat.
- iv) Kontratë Shitjeje e datës 16.6.2012, me palë blerëse shtetasin A. Xh. për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”.

**2.6** Kontrata nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 20.2.2012, me shtetasin D. L. për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, është depozituar në DPSHTRR.

Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.2012, me shtetasin D. L. për shitjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro nga subjekti i rivlerësimit nuk është depozituar në DPSHTRR. Kontrata e datës 16.6.2012 për shitjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me shtetasin A. Xh. nuk është dorëzuar në DPSHTRR.

**2.7** Kontrata e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.2012, me palë blerëse shtetasin D. L., me objekt shitjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1988, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, është kryer dy ditë para blerjes së automjetit tjetër të ri nga subjekti i rivlerësimit. Ato kanë të njëjtën vlerë, e cila duket pa një logjikë ekonomike referuar cilësisë dhe vjetërsisë së automjeteve respektive.

**2.8** Duket se kontrata e veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për shitjen në vitin 2012 të automjetit tip “\*\*\*\*”, janë fiktive. Në vijim, të ardhurat e pretenduara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2012: (i) në shkurt 6.000 (gjashtë mijë) euro; (ii) në qershor në shumën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë – nuk janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2012 si burim për blerjen e automjetit.

## **2.9** Nga kërkimi në AMF, për automjetin tip “\*\*\*\*”, rezulton:

- i) është prerë policë TPL për periudhën shkurt 2009 – qershor 2011 me pronar dhe përdorues subjektin e rivlerësimit e se pas kësaj periudhe nuk rezultojnë polica TPL të prera;
- ii) karton jeshil në muajin nëntor 2011 me pronar subjektin e rivlerësimit e se pas kësaj periudhe nuk rezulton policë karton jeshil i prerë.

**2.10** DPPPSH-ja<sup>5</sup> informon se ky automjet nuk është përdorur pas vitit 2011 për udhëtime jashtë Republikës së Shqipërisë. DPSHTRR-ja<sup>6</sup> informon Komisionin se automjeti tip “\*\*\*\*” ka rezultuar i regjistruar gjithmonë në emër të shtetasit Ndrëçim Troplini dhe se ky automjet është çregjistruar në datën 31.12.2017. Automjeti nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në pronësi të shtetasit A. H. Xh. apo ndonjë shtetasi tjetër.

**2.11** Komisioni ka pyetur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës lidhur me çështje të trajtuara me shtetasit D. L. dhe A. Xh. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet<sup>7</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

<sup>5</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2023.

<sup>6</sup> Shihni seksionin 30, dosja e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023.

<sup>7</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023.

**2.12 Nga analiza financiare e përgatitur nga Komisioni** ka rezultuar se për blerjen e automjetit në muajin shkurt 2012, llogaritur koston totale të blerjes në vlerën 1.049.361 (një milion e dyzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë (çmimi i blerjes 838.320 lekë + shpenzimet doganore 211.041 lekë), subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për blerjen e tij në shumën totale - 918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë.

<b>Analiza financiare datë 20.2.2012</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Blerë automjeti tip “****” (6.000 euro)	838.320
Shpenzime doganore etj., ***	211.041
<b>Vlera e automjetit tip “****”</b>	<b>1.049.361</b>
Pakësim likuiditetesh bankare	-2.754
Të ardhurat e dokumentuara nga paga	151.157
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”	0
<b>Total shpenzime</b>	<b>234.299</b>
Shpenzime jetese për 1 person	23.258
Shpenzime TIMS	0
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-918.708</b>

**2.13** Subjekti i rivlerësimit duket se është në pamjaftueshmëri financiare në shumën -918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë për koston totale të blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*” në shumën 1.049.361 (një milion e dyzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë (6.000 euro çmimi i blerjes + 211.041 lekë shpenzimet doganore), duke u mbajtur në konsideratë dokumentacioni ligjor i disponuar gjatë hetimit administrativ.

**2.13.1** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit të krijimit burimin e krijimit për automjetin tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, blerë në vitin 2012 në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Referuar edhe gjetjeve gjatë hetimit administrativ, mungesa e deklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* e bën të paplotë dhe të pasaktë deklarimin e subjektit.

**2.14 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**2.15** Në vijim të rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon: “*Automjeti tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 2006, figuron se është blerë nga shtetasi D. L. në shtetin gjerman në datën 26.1.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Komisioni thekson se shpenzimet doganore janë llogaritur në vlerën 211.041 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë mbi vlerën statistikore për automjetet e kësaj kategorie në shumën 1.055.211 (një milion e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë.*

*Unë kam blerë automjetin tip “\*\*\*\*” me targa të huaja me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 20.2.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, ekuivalent në shumën 838.320 (tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet) lekë, vlerë e cila përkon me vlerën e rënë dakord si çmim dhe të automjetit që unë kisha në pronësi, të cilën e kam këmbyer me shtetasin D. L. Komisioni ka paraqitur në analizën financiare përveç vlerës së automjetit edhe shpenzimet doganore, shpenzime të cilat nuk janë paguar nga ana ime.*

*Për shënimin e bërë nga Komisioni në rezultatet e hetimit “duket se ky automjet është importuar nga Gjermania qysh prej fillimit me blerës final subjektin e rivlerësimit...”, sqaroj se përlllogaritja e vlerës së automjeteve sipas vlerës statistikore është praktikë e aplikuar nga Dogana, por automjeti në rastin konkret është blerë nga kushëriri im D. L., i cili ka paguar edhe doganën e automjetit. Nga ana tjetër, mjeti është blerë në një shoqëri tregtare dhe ashtu siç besoj është e njohur edhe për Komisionin, blerësit e automjeteve rimburojnë vlerën e TVSH-së së këtyre automjeteve, me sa jam në dijeni në vlerën 20%, pra e njëjtë me vlerën e zhdoganimit në Shqipëri. Megjithatë, çmimi i të dy automjeteve është përcaktuar në lirinë kontraktore të palëve.*

*Ashtu siç theksova më sipër, burim i blerjes së automjetit është automjeti tip “\*\*\*”, me targë \*\*\*, i cili i është dorëzuar në këmbim të këtij automjeti shtetasit D. L. ( i afërmi im), i cili e ka sjellë këtë automjet nga Gjermania.*

*Nëse shitja do të ishte fiktive, nuk do të bëja pas kontratës së shitjes kontratë revokimi dhe më pas kontratë shitjeje përsëri me një shtetas të panjohur. Pra, fakti që kontrata është revokuar tregon më së miri që shitja nuk ka qenë fiktive po reale, ashtu siç unë kam deklaruar dhe se shkëmbimi ka ndodhur realisht. Regjistrimi i automjeteve në Drejtorinë Rajonale përkatëse është detyrim i blerësit.*

*Bazuar në shpjegimet e sipërcituara nuk rezulton të jem në pamundësi financiare për shkak sepse automjetin që kam tani në pronësi e kam shkëmbyer me automjetin tip “\*\*\*” dhe në datën 20.2.2012 nuk kam kryer asnjë pagesë. Analiza financiare në ditën që kam likuiduar shtetasin D. L. rezulton për shkak se në këtë datë kam arkëtuar vlerën e pagesës nga z. Xh., si dhe diferenca në shumën 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga të ardhurat nga paga”.*

**2.16** Në përfundim, trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport me dokumentacionin e administruar dhe përgjigjet e dhëna prej tij gjatë hetimit, vlerëson se automjeti tip “\*\*\*” i vitit 1988 nuk rezulton të jetë përdorur nga ndonjëri prej blerësve, porse përdoruesi i fundit ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2011, ku sipas deklarimeve në ILDKPKI në vitin 2011 mund të ketë bërë edhe një aksident<sup>8</sup>. Ky automjet ka rezultuar i regjistruar gjithmonë në emër të shtetasit Ndriçim Troplini dhe se është çregjistruar prej tij në datën 31.12.2017. Të gjitha veprimet e kryera për tjetërsimin e automjetit tip “\*\*\*” të vitit 1988 duket se kanë qenë fiktive e, për pasojë, nuk kanë prodhuar ndonjë efekt, pasi nuk rezulton e provuar në ndonjë mënyrë se automjeti është përdorur nga blerësi apo se shuma është përfituar nga subjekti i rivlerësimit.

**2.16.1** Lidhur me koston e llogaritur për blerjen e automjetit, referuar pretendimeve të subjektit se dogana është paguar nga shitësi, trupi gjykues vlerëson se kjo nuk ka një logjikë të pranueshme financiare e logjike, pasi edhe referuar këmbimit me automjetin tip “\*\*\*”, viti 1988, edhe referuar çmimit të blerjes, sipas llogaritjeve nuk ka pse shtetasi D. L. të dalë me humbje e se në këtë analizë është marrë në konsideratë vetëm vlera e automjetit sipas kontratës dhe ajo doganore (pra, kosto të automjetit). Fakti se pagesa e doganës është kryer nga shtetasi D. L. (në momentin e hyrjes së automjetit në pikën doganore) nuk është e mjaftueshme për të pranuar se ato shpenzime janë mbuluar prej tij. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**3. Pasuria tokë me sipërfaqe 1.850 m<sup>2</sup>**, në fshatin \*\*\*, Durrës, përfituar sipas ligjit nr. 7501, viti 1991, “Për tokën”, si anëtare e familjes bujqësore me kryetar z. R. S.

**3.1** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* dokumentacionin “Vërtetim datë 25.10.2016 nga Bashkia \*\*\*, Njësia Administrative \*\*\*\*”, ku vërtetohet se shtetasja E. S. është banore e fshatit \*\*\*, e furnizuar me tokë sipas ligjit nr. 7501, me sipërfaqe 1.850 m<sup>2</sup>.

**3.2** Personi i lidhur, bashkëjetuesja E. S.<sup>9</sup>, e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2013, ku citon pasurinë me sipërfaqe 9.370 m<sup>2</sup>, përfituar sipas ligjit nr. 7501, viti 1991, me përfaqësues të familjes bujqësore shtetasin R. S., në adresën fshati \*\*\*, Durrës. Si anëtare e familjes bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit përfiton pasuri me sipërfaqe 1.870 m<sup>2</sup>.

**3.3** Për këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika.

**4. Adresë vendbanimi:** “Lagja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*” (\*\*\*), pallati \*\*\*, kati \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Durrës”, deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe deklaratimet periodike.

**4.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë adresë vendbanimi në DPV-në e vitit 2014 dhe ka vazhduar ta deklarojë në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016.

<sup>8</sup> Shihni përgjigjet e pyetjes nr. 2, pyetësori datë 26.9.2011, i ILDKPKI-së.

<sup>9</sup> Është subjekt deklarues si punonjëse pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.



**4.2** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Tetor 2003 e deri në muajin gusht 2010 kam banuar në adresën Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati i \*\*\*, Durrës. Nga muaji gusht 2010 e deri në këtë moment jetoj në këtë adresë, Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*” – “\*\*\*\*” pallati nr. \*\*\*, kati i \*\*\*, Durrës. Të dyja këto adresa janë apartamente në pronësi të prindërve të mi M. dhe H. T.”.*

**4.3** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka verifikuar lidhur me këto pasuri në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Nga korrespondenca, ASHK Durrës informon Komisionin se në pronësi të shtetasve H. T. dhe M. T. janë këto pasuri:

- i) Apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> (nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*), shk. \*\*\*, kati i \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Durrës, përfituar me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2010, me palë blerëse H. T. dhe palë shitëse D. H. kundrejt çmimit 1.657.286 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.
- ii) Apartament me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, i cili ndodhet në shkallën \*\*\*, kati i \*\*\*, ngjitur me apartamentin me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, përfituar me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.3.2012, me palë blerëse H. T. dhe palë shitëse D. H. kundrejt çmimit 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
- iii) Apartament me sipërfaqe 73.4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës, fituar në datën 21.9.1993 nëpërmjet kontratës së privatizimit nga shtetasit M. T. dhe H. T.

**4.4** Apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, shkalla \*\*\*, kati i \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Durrës, përfituar me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2010, me palë blerëse H. T. dhe palë shitëse D. H. kundrejt çmimit 1.657.286 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, ku në përmbajtje të kontratës deklarohet se shitësi D. H. e ka fituar pronësinë në këtë apartament në datën 4.8.2005, të blerë nga pala shitëse E. M. me çmimin 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë.

**4.5** Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, të EKB-së, rezulton se çmimi mesatar i lirë i tregut për shitjen e apartamenteve në qytetin e Durrësit në vitin 2010 është 73.968 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë/m<sup>2</sup> dhe rezulton se vlera e përafërt e shitjes për pasurinë apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> do të ishte 4.068.240 (katër milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë.

**4.6** Apartament me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, i cili ndodhet në shkallën \*\*\*, kati i \*\*\*, ngjitur me apartamentin me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>. Sipas kontratës së shitblerjes, ky apartament është rivlerësuar në vlerën 5.739.580 (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë në datën 20.3.2012 nga pala shitëse, një ditë para se të lidhej kontrata e shitblerjes, e kjo pasuri i është shitur nënës së subjektit me çmim më të ulët se vlera e rivlerësimit.

**4.7** Nga hetimi rezulton se shtetasi D. H. e ka fituar pronësinë mbi apartamentin me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, me Certifikatën e Pronësisë së datës 20.3.2012, me origjinë nga legalizimi. Shtetasi D. H. ka aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t Durrës, me formular vetëdeklarimi për legalizim nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2006, për ndërtimin informal të shtesës anësore me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>. Rezulton se shtesa anësore është ndërtuar ngjitur me pasurinë apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. pasurie \*\*\* në pronësi të shtetasës H. S. T.

**4.8** FSHU-ja<sup>10</sup> informon Komisionin se në emër të shtetasës H. T. rezulton kontratë furnizimi me energji elektrike në rrugën “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, e çelur në datën 27.5.1998. Sipas sistemit të faturimit rezulton se për këtë kontratë ka pasur konsum të rregullt të energjisë qysh prej muajit shkurt 2007 e në vazhdim.

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2023.

**4.9** UK-ja<sup>11</sup> informon Komisionin se në emër të shtetases H. T. rezulton kontratë furnizimi me energji elektrike aktive nga data 29.7.2006 dhe se nuk ka pasur ndryshime të emrit të abonentit që prej vitit që është hapur kontrata deri aktualisht. Sipas sistemit të faturimit rezulton se për këtë kontratë ka pasur konsum të rregullt qysh prej muajit shkurt 2009 e në vazhdim.

**4.10** Nga hetimi rezulton se shtetasi D. H.:

- i) nga kërkimi në sistemin TIMS është i pajisur me kartë identiteti italiane qysh prej vitit 2003, ka jetuar jashtë Shqipërisë deri në vitin 2006 dhe më pas duket se jeton në Shqipëri e udhëton shpesh për në Itali;
- ii) nga kërkimi *online* në ASHK është pronar i disa pasurive të paluajtshme në qytetin e Durrësit.

**4.11** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me këto dy apartamente në emër të nënës së tij dhe ai ka shpjeguar se: *“Në lidhje me apartamentin që gjendet në katin e \*\*\* të pallatit nr. \*\*\*, me adresë Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*” – “\*\*\*\*”, Durrës dua të deklaroj se ky apartament është ndërtuar rreth viteve 1963 – 1965 me kontribut vullnetar sipas ligjeve të kohës dhe ka rreth 60 vite të shfrytëzohet. Gjithashtu, ky pallat ka edhe një shtesë anësore të ndërtuar nga ana veri-perëndimore të ndërtuar nga vetë banorët pas viteve 1990. Banorët e këtij pallati kanë arritur që me anë të procedurave të legalizimit të regjistrojnë në ASHK Durrës në vitin 2012 dhe pjesën e shtesës anësore, për të cilën nuk kishin dokumente pronësie. Me anë të Kontratës së Shitblerjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2010, përpiluar para noterit publik M. R., dhoma e noterisë Durrës, prindërit e mi kanë blerë nga shtetasi D. H. apartament banimi, ap. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati i \*\*\*, godina \*\*\* me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> ne çmimin 1.657.286 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë. Gjithashtu, pas përfundimit të procedurës së legalizimit dhe regjistrimit të shtesës anësore të pallatit, me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.3.2012, përpiluar para noterit M. R., dhoma e noterisë Durrës, prindërit e mi kanë blerë nga shtetasi D. H. edhe pjesën tjetër të apartamentit që ishte në proces legalizimi me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> në çmimin 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë dhe në kontratën e shitjes është i cilësuar fakti që kjo sipërfaqe (77 m<sup>2</sup>) është shtesë e AP \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, godina \*\*\* dhe ka qenë në proces legalizimi. Pra, apartamenti që posedonte shtetasi D. H. ishte 133 m<sup>2</sup> (56 + 77) dhe është blerë në dy periudha të ndryshme kohore, përkatësisht në vitet 2010 (56 m<sup>2</sup>) dhe 2012 (77 m<sup>2</sup>), pasi pronari i apartamentit, shtetasi D. H., dispononte në vitin 2010 dokumente pronësie vetëm për sipërfaqen prej 56 m<sup>2</sup> të apartamentit dhe në atë kohë sipërfaqja tjetër prej 77 m<sup>2</sup> ndodhej në proces legalizimi dhe regjistrimi dhe vetëm pas përfundimit të këtij procesi në vitin 2012, u bë e mundur edhe blerja e kësaj pjese takuese”.*

**4.12** Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me deklarimin e tij se ka qenë i ndarë në gjendjen civile nga prindërit e tij, por ndërkohë ka deklaruar bashkëjetesë dhe ekonomi të përbashkët me ta. Në vijim, në përgjigjen nr. 7 të pyetësorit të datës 8.2.2023 subjekti ka shpjeguar se: *“Në vitin 2001, unë dhe motra ime Dh. T. (T.) kemi qenë që të dy studentë, unë në Fakultetin Juridik në Tiranë dhe motra sapo ishte regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë. Duke qenë se ishim të dy studentë, për të përballuar shpenzimet e shkollës, motra dhe prindërit janë interesuar për përfitimin e ndonjë burse-ndihme ekonomike si student dhe nga interesimi pranë Bashkisë Durrës janë orientuar se e vetmja mënyrë që motra ime të fitonte bursë-ndihmë ekonomike si studente ishte që unë të ndahesha nga trangu familjar në gjendjen civile dhe të figuroja më vete, ndërsa motra të figuronte e regjistruar me prindërit. Kjo lloj ndarjeje ka qenë vetëm për këtë qëllim dhe e diktuar nga nevojat e sipërcituara. Siç kam deklaruar edhe në pyetësorin e parë unë kam jetuar me prindërit e mi dhe motrën në një banesë-apartament, kemi pasur një ekonomi të përbashkët dhe nuk kam paguar qira, por kam kontribuar për përballimin e shpenzimeve të jetesës, kemi pasur një ekonomi të përbashkët.*

<sup>11</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023.

*Kjo gjendje ka vazhduar deri në muajin nëntor 2017, kur kam bërë celebrim me bashkëshorten E. T. S. dhe nga ky moment figuroj në certifikatë së bashku me bashkëshorten time E.”.*

**4.13** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me burimet e ligjshme të nënës së tij për blerjen e kësaj pasurie në vitet 2010 dhe 2012 dhe ai ka shpjeguar në vijim se burimet janë:

- i) të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1991 – 2000, si shitës ambulantë, por të paregjistruar si persona fizikë/juridikë pranë zyrës së tatimeve;
- ii) të ardhurat nga paga e subjektit si prokuror;
- iii) të ardhurat nga punësimi i motrës Dh. T. si mjeke pranë njësisë vendore të kujdesit shëndetësor Durrës në vitet 2006 – 2010;
- iv) të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së babait M. T. nga viti 2006 e në vazhdim;
- v) dhuratë 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro nga tezja V. H., bërë nënës së subjektit në vitet 2006 – 2010;
- vi) kontratë huaje lidhur në vitin 2012, ku prindërit e subjektit i kanë marrë hua kushëritit të tyre Helidon Rruga shumë 1.000.000 (një milion) lekë me afat shlyerjeje 8-vjeçar.

#### **4.13.1 Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion provues si vijon:**

i) Vërtetim pensioni nga ISSH-ja lidhur me të ardhurat e përfituara nga pensioni i babait të tij, shtetasi M. T., i cili për periudhën 4.2.2006 – 31.12.2020 ka përfituar të ardhura në shumë 2.184.478 (dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

ii) Deklaratë Noteriale datë 12.3.2021 e motrës së tij, shtetases Dh. T., e cila deklaron se ka jetuar me familjen e vet (nënë, babain dhe vëllain) në apartamentin në pallatin nr. \*\*\* deri në vitin 2010 e se në vitin 2006 ka filluar punë si mjeke dhe ka kontribuar me pagën e saj në shpenzimet e jetesës së familjes. Në vijim, ajo deklaron se: *“Në muajin shtator 2010 jam martuar me shtetasin E. T., duke krijuar një familje më vete. Prindërit e mi në muajin qershor 2010 kanë blerë një apartament ngjitur me apartamentin e sipërcituar, me adresë Lagjia nr. \*\*, rruga “\*\*\*”, ish “\*\*\*” pallati \*\*\* dhe janë transferuar në këtë apartament. Me dëshirën e prindërve të mi dhe pëlqimin tim dhe të bashkëshortit, pas martese unë me bashkëshortin tim që nga muaji shtator 2010 e deri më sot kemi jetuar në apartamentin e vjetër të prindërve të mi, pallati \*\*\*. Për shkak të marrëdhënies së veçantë familjare, unë nuk kam paguar qira për përdorimin e këtij apartamenti, por vetë nga ana ime si vajza e tyre kam caktuar një kuotë për 10.000 (dhjetë mijë) lekë/muaj, të cilën nga muaji shtator 2010 e deri më sot ia kam dhuruar prindërve të mi për përballimin e shpenzimeve të tyre të jetesës”.*

iii) Vërtetim nga ISSH-ja dhe Qendra Shëndetësore nr. \*\*, Durrës, lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i motrës si mjeke për periudhën nëntor 2006 – dhjetor 2011.

iv) Deklaratë Noteriale nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 22.10.2018, e shtetases V. H., e cila deklaron se prej vitit 1991 ka qenë emigrante në Itali dhe se nga viti 2006 deri në vitin 2010 i ka dhuruar motrës së saj H. T. shumë 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, përkatësisht në vitin 2006 i ka dhuruar shumë 2.000 (dy mijë) euro, në vitin 2007 i ka dhuruar shumë 1.000 (njëmijë) euro, në vitin 2008 i ka dhuruar shumë 2.000 (dy mijë) euro, në vitin 2009 i ka dhuruar shumë 1.000 (njëmijë) euro dhe në vitin 2010 i ka dhuruar shumë 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.

v) Dokumentacion lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga punësimi në Itali i shtetases V. H. për periudhën 2003 – 2010.

vi) Deklaratë Noteriale datë 16.9.2021 e shtetasit H. Rr., i cili deklaron se me shtetasin M. T. janë kushërinj dhe se në vitin 2012 i ka dhënë hua shumë 1.000.000 (një milion) lekë me Kontratë Huaje datë 18.3.2012, pa interes, me afat shlyerjeje 8-vjeçar, me qëllim blerjen e një shtëpie, si dhe deklaron se huaja është kthyer totalisht brenda afatit 8-vjeçar.

vii) Kontratë Huaje (jonoteriale) datë 18.3.2012, me palë huadhënëse H. Rr. dhe palë huamarrëse M. dhe H. T., për dhënien hua të shumë 1.000.000 (një milion) lekë.

viii) Kopje të ekstraktit historik të shoqërisë tregtare “\*\*\*\*” sh.p.k., me ortak të vetëm shtetasin H. Rr., e themeluar në datën 8.1.2004, si dhe ka bashkëlidhur pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare për periudhën 2010 – 2012.

**4.14** DRT Durrës<sup>12</sup> informon Komisionin se nuk rezultojnë të dhëna që shtetasit H. T. apo M. T. të kenë qenë të regjistruar me aktivitet tregtar.

**4.15** ISSH Durrës<sup>13</sup> informon Komisionin se nëna e subjektit të rivlerësimit përfiton pension pleqërie me datë fillimi 1.9.2015 dhe përfiton aktualisht vlerën 17.566 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë/muaj dhe se babai i subjektit përfiton pension pleqërie me datë fillimi 4.2.2006 dhe përfiton aktualisht vlerën 16.366 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë/muaj.

**4.16** Komisioni ka pyetur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>14</sup> lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin H. Rr. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**4.17** Komisioni ka pyetur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>15</sup> lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin D. H. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**4.18** Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e subjektit nga paga si prokuror, të deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* përdorimin e kësaj pasurie të paluajtshme apo shpenzimet e kryera ndër vite si kontribut për familjen e vet, si dhe nuk ka deklaruar në DPV-të përkatëse kursime *cash* në banesë dhe as nuk ka deklaruar shpenzime monetare si kontribut për familjen në DPV-të përkatëse.

#### **4.19 Analiza financiare për blerjen e apartamenteve në vitet 2010 dhe 2012**

##### **4.19.1 Pasuria apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, blerë në qershor 2010 në vlerën 1.657.286 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë**

Komisioni ka kryer analizën financiare. Në këtë analizë: (i) janë marrë në konsideratë kursimet e mundshme të familjes, duke marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara deri në këto momente nga pensioni i babait dhe punësimi i motrës; (ii) nuk është konsideruar dhurata nga tezja në shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro si burim deri në këto momente; (iii) është konsideruar mundësia për kursime nga të ardhurat e subjektit si prokuror për periudhën 2006 – qershor 2010, duke marrë në konsideratë deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit se ka jetuar në ekonomi të përbashkët me prindërit e tij.

<b>Analiza financiare 2.2006 - 6.2010</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat nga babai nga pensioni	680.197
Të ardhurat e motrës	1.156.969
Të ardhurat e nënës	0
Të ardhura nga aktiviteti ambulant i prindërve, paregjistruar në vitet 1991 – 2000	0
<b>Total të ardhura të dokumentuara të familjes</b>	<b>1.837.166</b>
Dhuratë nga tezja 7.500 euro (të ndara në pjesë nga vitet 2006 – 2010)	0
<b>Shpenzime jetese (3 persona - babai + nëna + motra)</b>	<b>2.006.447</b>
Mundësia për kursime e prindërve	-169.281
<b>Mundësi për kursime nga subjekti (2006 – 6.2010)</b>	<b>2.602.389</b>
Blerje apartamenti 56 m <sup>2</sup> në vitin 2010	1.657.286
<b>Rezultati neto</b>	<b>775.822</b>

<sup>12</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2023.

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2023.

<sup>14</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023.

<sup>15</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023.

#### 4.19.2 Pasuria apartament me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, deklaruar e blerë në mars 2012 në vlerën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë

Komisioni ka përgatitur analizën financiare për periudhën korrik 2010 – mars 2012 dhe ka marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara deri në këto momente nga pensioni i babait, si dhe huan e dhënë nga shtetasi H. Rr. në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në vitin 2012. Lidhur me mundësinë e kursimeve nga të ardhurat e subjektit, nga analiza e përgjithshme rezultojnë se deri në këto momente subjekti i rivlerësimit del me balancë negative në vitin 2011 për mbylljen para kohe të kredisë dhe me balancë negative deri në muajin mars 2012 për blerjen e pasurisë \*\*\*.

Analizë financiare 7.2010 – 3.2012	Vlera në lekë
Të ardhurat nga babai nga pensioni	261.614
Të ardhurat e nënës	0
<b>Total të ardhura të dokumentuara</b>	<b>261.614</b>
Hua nga shtetasi H. Rr.	1.000.000
Shpenzime jetese nëna + babai	479.634
<b>Mundësia për kursime e prindërve</b>	<b>781.980</b>
<b>Mundësi për kursime nga të ardhurat e subjektit<sup>16</sup></b>	<b>0</b>
Blerje apartamenti në vitin 2012	2.500.000
<b>Rezultati neto</b>	<b>-1.718.020</b>

4.20 Sa i përket pasurisë apartament me sipërfaqe 73.4 m<sup>2</sup> ajo është fituar në datën 21.9.1993 nëpërmjet kontratës së privatizimit nga shtetasi M. Tr. dhe H. T.. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2004 – 2013 si adresë banimi: Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, Durrës. Sipas deklarimeve, në këtë pasuri jeton motra e subjektit të rivlerësimit.

#### 4.21 Në përfundim, rezultojnë se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* përdorimin e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 133 m<sup>2</sup> (pasuria apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> dhe pasuria apartament me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>) në pronësi të nënës së tij, duke mos përmbushur detyrimet e përcaktuara në pikën 14 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së mbi plotësimin e deklaratës *Vetting*. Subjekti duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
- ii) Rezultojnë se çmimi i blerjes së apartamentit me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> nga nëna e subjektit në vitin 2010 është më i ulët se çmimi i blerjes së apartamentit nga pala shitëse rreth 5 vjet më parë dhe disa herë më i ulët se çmimi referuar EKB-së.
- iii) Rezultojnë se çmimi i blerjes në vitin 2012 i apartamentit 77 m<sup>2</sup> në vlerën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë është më i ulët se çmimi i rivlerësimit në vlerën 5.739.580 (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë, të kryer nga shitësi një ditë para se të lidhej kontrata e shitblerjes me nënën e subjektit.
- iv) Ngrihen dyshime se apartamenti me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, blerë me kontratë shitblerjeje në vitin 2010, dhe apartamenti me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, blerë me kontratë shitblerjeje në vitin 2012, janë marrë në përdorim prej familjes së subjektit para se të lidheshin kontratat e shitblerjes dhe se ato janë përdorur si një apartament i vetëm qysh prej fillimit kur janë hapur kontratat e utiliteteve në vitin 2006.
- v) Duket se nëna e subjektit është në pamundësi financiare në shumën -1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë për të blerë apartamentin me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> në vitin 2012.

<sup>16</sup> Pasi ka shpenzuar për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”.

vi) Komisioni ngre dyshime se pasuria apartament banimi me sipërfaqe 133 m<sup>2</sup> mund të jetë pasuri e krijuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën ai duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm që nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

#### **4.22 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**4.23** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Në DPV-të 2014 e në vazhdim, si dhe në deklaratën Vetting, adresa e banimit është: Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”), pallati \*\*\*, kati \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Durrës. Nga tetori i vitit 2003 e deri në muajin gusht 2010 kam banuar në adresën Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, kati i \*\*\*, Durrës. Nga muaji gusht 2010 e deri në këtë moment jetoj në këtë adresë Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”), pallati nr. \*\*\*, kati i \*\*\*, Durrës. Të dyja këto adresa janë apartamente në pronësi të prindërve të mi M. dhe H. T.. Duke deklaruar adresën e banimit vlerësoj se shuhet çdo dyshim “se mosdeklarimi formal në përdorim të kësaj pasurie në faqen nr. 05 të deklaratës Vetting është kryer me qëllim fshehjen”.

*Burimi i krijimit të blerjes së këtij apartamenti, ndër të cilat edhe të ardhurat nga paga si prokuror, janë deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, sepse prindërit e mi nuk kanë qenë persona të lidhur sipas ligjit nr. 84/2016 apo edhe sipas ligjit nr. 9049/2003. Ka rezultuar e provuar dhe pa asnjë dyshim se kam jetuar në një familje dhe ekonomi të përbashkët me nënën dhe babain tim dhe, përveç blerjes së automjeteve, nuk kam kryer asnjë shpenzim dhe nuk kam pasur likuiditete.*

*Nga ana tjetër, ashtu siç është konsoliduar edhe në jurisprudencën e Kolegjit përdorimi i apartamentit të prindërve pa qira nuk i bën prindërit persona të tjerë të lidhur.*

*Me anë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2010, prindërit kanë blerë nga shtetasi D. H. apartament banimi, ap. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati i \*\*\*, godina \*\*\*, me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> në çmimin 1.657.286 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë. Gjithashtu, pas përfundimit të procedurës së legalizimit dhe regjistrimit të shtesës anësore të pallatit, me anë të Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.3.2012, prindërit kanë blerë nga shtetasi D. H. edhe pjesën tjetër të apartamentit, i cili ishte në proces legalizimi me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> në çmimin 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë. Në kontratën e shitjes është i cilësuar fakti që kjo sipërfaqe (77 m<sup>2</sup>) është shtesë e Ap. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati i \*\*\*, godina \*\*\* dhe ka qenë në proces legalizimi. Pra, apartamenti që posedonte shtetasi D. H. ishte 133 m<sup>2</sup> (56 + 77) dhe është blerë në dy periudha të ndryshme kohore, përkatësisht në vitet 2010 (56 m<sup>2</sup>) dhe 2012 (77 m<sup>2</sup>), pasi pronari i apartamentit, shtetasi D. H., dispononte në vitin 2010 dokumente pronësie vetëm për sipërfaqen 56 m<sup>2</sup> të apartamentit dhe, në atë kohë, sipërfaqja tjetër prej 77 m<sup>2</sup> ndodhej në proces legalizimi dhe regjistrimi. Pas përfundimit të këtij procesi në vitin 2012, u bë e mundur edhe blerja e kësaj pjese takuese sipas kontratës së vitit 2012.*

*Lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit, udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010, i EKB-së, përcakton çmimin mesatar në tregun e lirë, ku përfshihen edhe apartamentet e ndërtruara të reja dhe me teknologji më të mirë deri në vitin 2010. Fakti që vlera e apartamentit është shumë larg vlerës mesatare të tregut duket edhe nga vlera që shitësi D. H. e ka blerë këtë apartament në vitin 2005 me çmim 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, e cila është vlerë e përafërt me vlerën e blerë nga nëna ime. Është e vërtetë që nëna ime e ka blerë këtë apartament pak më lirë sesa çmimi i blerë nga vetë z. H., por duhet të kihet në vëmendje fakti se pas 5 vitesh apartamenti ishte akoma më i amortizuar dhe, nga ana tjetër, nga viti 2005 deri në vitin 2010 kërkesa për blerjen e apartamenteve të vjetra në Durrës ka rënë për shkak të ndërtimit në këtë kohë të shumë pallateve të reja dhe cilësore.*

*Apartamenti me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> është blerë nga nëna me çmimin 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë nga pala shitëse D. H.. Është e vërtetë që në kontratën shitblerjes shënohet se ky apartament është rivlerësuar në vlerën 5.739.580 (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e*

nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë në datën 20.3.2012, por në fakt nuk është kryer asnjë rivlerësim. Vlera e përcaktuar në kontratë dhe në kartelën e pasurisë është përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, ndryshuar me Urdhrin nr. 21, datë 26.2.2009, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar. Pra, nuk ka rivlerësim po vetëm përcaktim të vlerës në shitje sipas parashikimeve të udhëzimit të sipërcituar në momentin kur është lidhur kontrata.

Vlera e blerjes së apartamentit është ajo e përcaktuar në kontratë dhe çmimi si element thelbësor i kontratës është real dhe kurrsesi fiktiv.

Të dyja apartamentet janë në përdorim nga prindërit e subjektit të rivlerësimit që në vitin 2010 (dhe jo që nga viti 2006). Por, meqenëse sipërfaqja 77 m<sup>2</sup> nuk ishte e legalizuar, është rënë dakord me shtetasin D. H. se kontrata e shitblerjes do të nënshkruhej kur të legalizohej sipërfaqja e ndërtuar në mënyrë informale dhe në të njëjtën kohë do të kryheshin edhe pagesat (pra, kur të legalizohej edhe të nënshkruhej kontrata), provuar me librezën e energjisë elektrike për abonentin nr. \*\*\* dhe përgjigjen e UK-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2023, në bazë të Kontratës nr. \*\*\*, datë 24.6.2010 (depozituar nga subjekti).

Burimet e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitet 2010 e 2012, janë specifikisht: të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1991 – 2000 si shitës ambulant, por të paregjistruar si persona fizikë/juridikë pranë zyrës së tatimeve; të ardhurat nga paga e subjektit si prokuror; të ardhurat nga punësimi i motrës Dh. T. si mjeke pranë njësisë vendore të kujdesit shëndetësor Durrës në vitet 2006 – 2010; të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së babait M. T. nga viti 2006 e në vazhdim; dhuratë 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro nga tezja V. H., bërë nënës së subjektit në vitet 2006 – 2010; kontratë huaje lidhur në vitin 2012, ku prindërit e subjektit i kanë marrë hua kushëririt të tyre H. Rr. shumën 1.000.000 (një milion) lekë me afat shlyerjeje 8-vjeçar.

Lidhur me të ardhurat e tezes në shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro për periudhën 2003 – 2010, të cilat nuk do të konsiderohen si burim i ligjshëm nga Komisioni në vitet 2003 – 2010, rezulton se të ardhurat e ligjshme të familjes së tezes në emigracion janë shumë të mira dhe, si rrjedhojë, ajo e justifikon lehtësisht me të ardhura të ligjshme dhurimin në shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro.

Në lidhje me analizën financiare për periudhën korrik 2010 – mars 2012 Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara deri në këto momente nga pensioni i babait dhe huan e dhënë nga shtetasi H. Rr. në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në vitin 2012. Në këtë analizë financiare kanë konsideruar 0 (zero) mundësinë e kursimeve nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, për shkak se nga analiza e përgjithshme e kryer nga Komisioni rezultoi me balancë negative në vitin 2011 për mbylljen para kohe të kredisë dhe me balancë negative deri në muajin mars 2012 për blerjen e pasurisë \*\*\*. Në fakt, balanca e muajit mars 2012 nuk është negative dhe as viti 2011 nuk ka balancë negative, por pozitive. Mbyllja e kredisë është likuiduar kryesisht me vlerën e marrë kredi për shkak të mospërdorimit të kësaj shume.

Rezulton se mundësia e subjektit për kursime është në shumën 2.895.303 (dy milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tre) lekë. Kjo për shkak se nga mundësia për kursim e subjektit deri në vitin 2010 janë përdorur në analizën financiare të po këtij viti, për blerjen e apartamentit vetëm 785.492 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, kursime të realizuara deri në këtë moment (1.657.286-872794 = 785.492 lekë) dhe diferenca e kursimet së bashku me mundësinë për kursim nga momenti i blerjes së apartamentit në vitin 2010 deri në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2012 ka rezultuar në shumën 2.895.303 (dy milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tre) lekë. Si rrjedhojë, rezulton se nëna ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojë edhe apartamentin me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> në vitin 2012”.

**4.24** Në vlerësimin përfundimtar, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën Vetting, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e

familjarëve të tij, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kishin detyrimin që të deklaroronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit. Ky qëndrim vjen edhe nisur nga rezultatet e hetimit, ku pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie janë kryesisht të ardhurat e pagës së tij e disa hua të deklaruara për efekt të këtij procesi. Këto deklarime lidhur me burimet nuk gjejnë pasqyrim në asnjë deklaram periodik apo të dhëna të deklaratës *Vetting*. Nga vlerësimi i procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive dhe interesave privatë” të datës 1.2.2016, mbajtur në ILDKPKI, pyetjes nr. 2 “*Ku banoni aktualisht, a keni pasuri të paluajtshme në emrin tuaj, sa shpenzoni për banim?*”, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se pasuria është krijuar me të ardhura të aktivitetit tregtar të prindërve dhe se ai kontribuon në familje sipas nevojave, shpenzime normale.

**4.24.1** Në lidhje me këtë pasuri trupi gjykues vlerëson se në bazë të parashikimit të pikës 5 të nenit Ç dhe pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të provuar bindshëm burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.

**4.24.2** Deklarimi i subjektit se vlera e pasurisë ishte në emër të prindërve ndaj nuk ishte e detyrueshme të deklarohej në deklaratat e pasurisë apo deklaratën *Vetting*, nuk shpjegon se përse vlerat e investuara prej tij në krijimin e kësaj pasurie nuk u deklaruan ndër vite apo burimi i krijimit të kësaj pasurie nuk u deklarua në deklaratën *Vetting*, megjithëse, pjesa e pretenduar e investuar prej tij përbën edhe pjesën më të madhe të investimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjëherë se sa është konkretisht vlera e investuar prej tij, pse prindërit e tij u larguan nga shtëpia që ata kishin në pronësi (e që vijnë ende ta kenë) për të jetuar së bashku me subjektin e rivlerësimit në një shtëpi tjetër kur nuk kishin as mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie, në mënyrë që Komisioni, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, të krijonte bindjen se pasuria me sipërfaqe 133 m<sup>2</sup> ishte pasuri e nënës së subjektit dhe me burime financiare të mjaftueshme për krijimin e saj.

**4.24.3** Në kushtet kur nga deklaramet e vetë subjektit të rivlerësimit, u pretendua se kjo pasuri është krijuar nga burime ardhurash të prindërve dhe të ardhurat e tij nga paga, megjithëse në mungesë të plotë të ndonjë deklarimi ndër vite, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në një qëndrim tejet garantist, duke ndjekur pretendimet e subjektit, rezultoi përsëri se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën -1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë. Komisioni vlerëson se huaja e deklaruar nga teza e tij nuk është e dokumentuar me akte provuese për kohën kur deklarohet se është dhënë, nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën *Vetting*, si dhe duke qenë se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se ekzistenca e kësaj huaje mbetet në nivel deklarativ e se është kryer për të mbuluar balancat negative të rezultuara nga hetimi administrativ.

Në këtë analizë nuk janë llogaritur shpenzime arredimi, kosto të tjera për rregullime apo përshtatje, si dhe vlerat e pasurive janë marrë në konsideratë sipas kontratave përkatëse (nisur edhe nga fakti se pasuria është ndërtim i vjetër).

**4.24.4** Lidhur me pretendimet e subjektit që analizës financiare t’i shtohen edhe të ardhura e kursime të tij për periudhën 2011 – 2012, trupi gjykues nuk i ka pranuar ato, pasi nuk ka pranuar as qëndrimet e subjektit lidhur me shlyerjen e kredisë në vitin 2012, trajtuar më poshtë në këtë vendim, duke konstatuar se diferenca negative mbetet së paku 1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë për krijimin e kësaj pasurie, e cila në vlerësim të trupit gjykues është një pasuri e përbashkët edhe me subjektin e rivlerësimit, referuar burimit të deklaruar të krijimit të saj nga vetë subjekti i rivlerësimit.

**4.24.5** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting* lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë e se ai nuk mundi të provojë në bazë të parashikimit të pikës 5 të nenit Ç dhe pikave 3 dhe 5 të nenit D të



Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

## **5. Kredi bankare në emër të subjektit të rivlerësimit në shumën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë në Raiffeisen Bank**

**5.1** Subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e vitit 2011 se ka marrë kredi në Raiffeisen Bank në muajin nëntor 2010 në shumën 1.000.000 (një milion) lekë dhe se e ka shlyer plotësisht atë në datën 15.2.2011. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në periodike qëllimin e përdorimit të kredisë dhe as burimin e të ardhurave të përdorura për shlyerjen e saj vetëm 3 muaj pas marrjes.

**5.2** Nga aktet e administruara nga Raiffeisen Bank ka rezultuar se: (i) në datën 17.11.2010, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare për marrjen e kredisë në shumën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, me qëllim përdorimin e saj për arsye personale, me afat shlyerjeje 7 vjet; (ii) në datën 18.11.2010, në llogarinë e pagës janë disbursuar fondet e kredisë në vlerën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë; (iii) në të njëjtën datë është tërhequr *cash* shuma 940.000 (nëntëqind e dyzet mijë) lekë nga subjekti i rivlerësimit; (iv) në datën 15.2.2011, subjekti ka derdhur *cash* shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë për mbyllje para kohe të kredisë.

**5.3** Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për mbylljen para kohe të kredisë dhe ai ka shpjeguar se kredinë e ka marrë për një operim të mundshëm për sëmundjen e hernies diskale dhe, duke qenë se operimi u shty, fondet e kredisë i përdori për mbylljen e kredisë.

**5.4** Në procesverbalin datë 26.9.2011 të ILDKPKI-së, në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka marrë kredinë në Raiffeisen Bank për kryerjen e një operacioni në Itali “*pas një aksidenti të kryer me makinë e për shkak se operacioni u shty*”, në datën 15.2.2011 e ka shlyer totalisht kredinë.

**5.5** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vitin 2010.

**5.6** Komisioni ka përgatitur analizën financiare lidhur me mundësitë financiare për krijimin e likuiditeteve *cash* në shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë për mbylljen e kredisë para kohe dhe duket se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në shumën -892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për krijimin e kësaj shume.

<b>Analiza financiare datë 15.2.2011</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>Mbyllje para kohe e kredisë</b>	<b>1.009.000</b>
Gjendje <i>cash</i> në banesë 31.12.2010	0
Shtesë likuiditetesh bankare	3.383
Të ardhurat e dokumentuara nga paga	160.480
<b>Total shpenzime</b>	<b>41.090</b>
Shpenzime jetese	22.770
Shpenzime këst kredie janar 2011	18.320
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-892.993</b>

**5.7 Në përfundim**, subjekti i rivlerësimit duket se është në pamjaftueshmëri financiare në shumën -892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për krijimin e likuiditetit *cash* në shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë, përdorur për mbylljen para kohe të kredisë.

**5.8 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**5.9** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon: “Kredia është marrë për kryerjen e një ndërhyrjeje kirurgjikale (hernie diskale), e cila nuk u krye pas këshillimit me mjekët. Për këtë arsye, në datën 15.2.2011 është derdhur cash në bankë shuma 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë, duke mbyllur/shlyer para kohe kredinë.

Burim i shlyerjes së kredisë është gjendja cash e krijuar në banesë në vitin 2010, me burim fondet e tërhequra nga kredia bankare dhe pjesa e mbetur të ardhurat nga paga.

Pranoj pasaktësinë e mosdeklarimit të marrjes së kësaj kredie në vitin 2010 dhe mosdeklarimin e gjendjes cash në fund të vitit 2010, por kjo pasaktësi ka ndodhur për shkak se në mars të vitit 2011, kohë kur është përpiluar DPV-ja e vitit 2010, kredia bankare ishte shlyer në shkurt të vitit 2011 (pra, kur kam përpiluar DPV-në e vitit 2010 kredia bankare ishte shlyer kryesisht me gjendjen cash të tërhequr nga disbursimi i kredisë).

Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes cash në fund të vitit 2010, bazuar edhe në praktikën e vendimmarrjeve<sup>17</sup> të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duhet të marrë parasysh:

- Korrigjimin e deklarimit të vitit 2010, sipas deklarimit tim përpara inspektorit në vitin 2011, si dhe deklarimin e marrjes dhe shlyerjes së kredisë në vitin 2011.
- Diferencën e thellë mes vlerës së mundshme të kursimit për vitin 2010 [në analizën financiare të përlllogaritur nga Komisioni vendoset si shpenzim në vitin 2010, shuma e disbursuar e kredisë, por në fakt me këtë shumë nuk është kryer asnjë investim apo shpenzim. Nëse në analizën e kryer nga Komisioni hiqet ky shpenzimin i pakryer, shpenzim i cili nuk ka rezultuar gjatë hetimit të Komisioni, balanca e vitit 2010 është 1.181.982 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy)] dhe pamundësinë e përlllogaritur në shkurt të vitit 2011 (diferenca pozitive e vitit 2011 është më e lartë se gjendja e derdhur në bankë në shkurt të vitit 2011).
- Faktin që diferenca shumë pozitive e analizës financiare e vitit 2011 vjen si rrjedhojë e ekzistencës së burimeve të ligjshme të të ardhurave të mia (kredi + paga).
- Kohën relativisht të shkurtër nga momenti i tërheqjeve të likuiditetit nga llogaritë bankare nëntor 2010, deri në datën e shlyerjes së kësaj llogarie bankare shkurt 2011. Koha shumë e shkurtër duhet të bindë Komisionin se deklarimi im është i sinqertë dhe duhet të shuajë çdo dyshim të arsyeshëm.
- Ky vlerësim duhet të bazohet jo vetëm në trendin e shpenzimeve të kryera nga ana ime gjatë gjithë periudhës objekt rivlerësimi, por edhe për shkak të mungesës së të dhënave apo indicieve gjatë hetimeve të kryera, për ekzistencën e shpenzimeve të shtuara qoftë edhe vetëm në formën e dyshimit mbi ekzistencën e tyre, si rrjedhojë e ngjarjeve apo ndodhjeve, të cilat mund të justifikonin krijimin e këtij shpenzimi.

Bazuar në argumentet e sipërcituara analiza financiare rezulton se kam pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj kredie, duke vërtetuar të kundërtën e barrës së provës së njoftuar nga Komisioni”.

**5.10** Në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se nuk janë paraqitur prej tij prova se shuma e përdorur për likuidimin e kredisë në shkurt të vitit 2011 është ajo e tërhequr cash nga vetë ai në nëntor të vitit 2010. Bazuar edhe në bindjen e brendshme, trupi gjykues vlerëson se në mungesë të deklarimeve të kohës apo provave e fakteve të pakontestueshme, vlerësimi i rrethanave të faktit të çon në përfundimin se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Ai nuk paraqiti asnjë dokument se kishte planifikuar apo organizuar konkretisht një ndërhyrje që të jetë anuluar për shkaqe objektive, ndaj edhe aplikimi

<sup>17</sup> Vendimet e Kolegjit: nr. 37/2021; nr. 20, datë 31.7.2019; nr. 1, datë 12.1.2021; nr. 1, datë 27.1.2022.

i kredisë në shumën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, tërheqja e saj *cash* një ditë pas kalimit të fondeve, mbajtja e tyre në shtëpi pa një plan apo ofertë/kosto konkrete të vlerës së operimit, e bën të pabesueshëm shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, gjatë shpjegimeve në seancë dëgjimore ai u shpreh se ka vuajtur nga hernia diskale për një kohë të gjatë dhe ka paraqitur një sërë dokumentesh për ta provuar këtë fakt, por asnjë dokument për të provuar se kishte një plan realist për operim/kurim. Ndërkohë, nga shpjegimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 26.9.2011, pyetja nr. 2, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se ka marrë kredi në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në nëntor 2010 për kryerjen e një operacioni në Itali pas një aksidenti me makinë. Gjithashtu, Komisioni në këtë vlerësim mban në konsideratë se në vitin 2010 – 2011 llogaritja e shpenzimeve është vetëm ajo bazike sipas ILDKPKI-së, pa përfshirë kura mjekësore, arredim/mobilim apo kosto të tjera, që duken nga hetimi administrativ të jenë realizuar në këtë periudhë.

**5.11 Në përfundim**, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, për likuidimin e kredisë në vitin 2011.

## **6. Fond investimi në shumën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, në Raiffeisen Bank, investuar nga nëna e subjektit të rivlerësimit**

**6.1** Nga hetimi ka rezultuar se shtetasja H. T. ka investuar në fond investimi në vitin 2015 vlerën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, në Raiffeisen Invest, e krijuar nga: (i) derdhje *cash* në datën 5.1.2015, të shumës 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë; (ii) derdhje *cash* në datën 12.6.2015, të shumës 950.000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me përshkrimin “Të ardhura nga emigracioni i të afërmeve në Itali” dhe se ka tërhequr *cash* në datën 13.6.2019 shumën 2.295.195 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, e përfituar nga maturimi i fondit të investimit.

**6.2** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës së tij, i cili në përgjigje të pyetësorit të datës 17.2.2023 ka shpjeguar: *“Dua të deklaroj se tezja ime, shtetasja V. H., e martuar me shtetasin Xh. Gj., ka përfituar prona si troje njësi shërbimi – dyqane, banesa, si dhe kompensime monetare nga trashëgimlënësit e bashkëshortit të saj. Këto prona janë të stacionuara kryesisht në qytetet Tiranë dhe Durrës. Gjithashtu, nga viti 2009 e në vijim disa nga pronat tezja, së bashku me bashkëshortin, i kanë pasur dhënë me qira. Duke qenë se jetojnë në Itali, në pamundësi për t’i ndjekur, kanë autorizuar dhe prokuruar nënën time, shtetasen H. T., që të tërheqë cash në mënyrë periodike të ardhurat nga qiratë e pronave, të cilat nëna ime i ka ruajtur në banesë. Në një moment kur u arrit një shumë e konsiderueshme parash nga mbledhja periodike e qirave, me kërkesë të tezes, në vitin 2015 këto lekë janë depozituar në Raiffeisen Bank, ku sipas punonjësve të bankës dhe me miratimin e tezes depozita më e leverdishme në atë kohë ka qenë fondi i investimit. Deklaroj se shuma e depozituar në Raiffeisen Bank në vitin 2015 janë paratë e grumbulluara nga qiratë e dyqaneve, banesave dhe pronave të tjera të tezes dhe bashkëshortit të saj, ku nëna ime ka qenë e autorizuar për t’i tërhequr dhe ruajtur ato”.*

**6.3** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues:

i) Deklaratë (jonoteriale) e shtetasës H. T., e cila deklaron se motra e saj ka përfituar nga bashkëshorti i saj prona në qytetin e Tiranës dhe se disa prej tyre janë dhënë me qira prej vitit 2009 e në vazhdim.

ii) Deklaratë (jonoteriale) e shtetasës V. H., e cila deklaron se bashkëshorti i saj ka përfituar disa prona në qytetin e Tiranës me trashëgimi, përkatësisht një banesë trekatëshe në rrugën “\*\*\*”, si dhe një dyqan me adresë në rrugën “\*\*\*”, të cilat janë dhënë me qira prej vitit 2009 e në vijim. Ndër të tjera, ajo deklaron se ka autorizuar motrën e saj, shtetasen H. T., për të tërhequr *cash* në mënyrë periodike të ardhurat nga qiratë e pronave, përkatësisht 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) euro/muaj nga qiraja e banesës trekatëshe dhe 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj nga qiraja e dyqanit dhe se këto të ardhura janë mbledhur e depozituar nga shtetasja

H. T. në llogarinë e saj në Raiffeisen Bank, përkatësisht në muajt janar dhe qershor të vitit 2015.

iii) Aktet për vërtetimin e pronësisë në emër të shtetasit Xh. Gj., përkatësisht: Kontratë Pjesëtimi Vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.9.1996; Vërtetim Pronësie datë 18.1.1996; Vendim nr. \*\*\*, datë 26.6.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; Dëshmi Trashëgimie nr. \*\*\*, datë 8.6.1993; prokurë e posaçme.

iv) Kontratë Qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.5.2009, me objekt “Lëshimi me qira i një banese trekatëshe (ish-rajoni i policisë)”, me adresë rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 25.9.1995, me palë qiradhënëse shtetasin Xh. Gj., me pjesë takuese 1/8, i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Gj. Afati i qirasë është për një periudhë 10-vjeçare, e cila fillon në datën 11.5.2009 deri më 11.5.2019, me qira mujore 2.000 (dy mijë) euro/muaj për 5 vitet e para dhe për 5 vitet e dyta qiraja mujore do të jetë në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro/muaj.

v) Kontratë Qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.3.2019, me palë qiradhënëse shtetasin Xh. Gj., me pjesë takuese 1/3, me objekt “Dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme”, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sipërfaqe totale 26.13 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/muaj, me afat 5-vjeçar.

**6.4** Nga kërkimi në regjistrin e gjendjes civile të vitit 2008, rezulton se shtetasja V. H. është e martuar me shtetasin Xh. Gj.

**6.5** Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se provohet marrëdhënia e qirasë për objektin trekatësh dhe se shtetasja V. H. mund të ketë përfituar prej vitit 2009 deri në qershor 2015 të ardhura në shumën 13.000 (trembëdhjetë mijë) euro [ekuivalent në vlerën 1.805.087 (një milion e tetëqind e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë<sup>18</sup>], ndërkohë, lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiraja e dyqanit, rezulton se kontrata e qirasë fillon në vitin 2019.

**6.6** Nga hetimi rezulton se nuk ka dokumentacion ligjor provues që vërteton se fondi i investimit i krijuar nga nëna e subjektit me depozitim *cash* prej saj ka si burim të ardhurat e motrës.

**6.7** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për krijimin e këtij fondi, duke marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara të subjektit, prindërve të tij dhe bashkëjetueses, si dhe shpenzimet përkatëse, nga e cila rezulton se ata janë në pamundësi në shumën -1.191.963 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë për krijimin e fondit të investimit në shumën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë.

<b>Analiza janar – qershor 2015</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat nëna	0
Të ardhurat babai (pension)	91.565
Të ardhurat subjekti	593.381
Të ardhurat bashkëjetuesja	405.416
<b>Total të ardhura</b>	<b>1.090.361</b>
Shpenzime jetese nëna + babai <sup>19</sup>	91.565
Shpenzime jetese subjekti + bashkëjetuesja <sup>20</sup>	224.276
Shpenzime të tjera të subjektit dhe bashkëjetueses	66.484
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>708.037</b>
<b>Fondi i investimit në vlerën 1.900.000 lekë</b>	<b>1.900.000</b>
<b>Rezultati</b>	<b>-1.191.963</b>

**6.8 Në përfundim**, duket se nëna e subjektit të rivlerësimit është në pamjaftueshmëri financiare në shumën -1.191.963 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë për krijimin e fondit të investimit në shumën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë)

<sup>18</sup> Kursi mesatar i këmbimit 138.8 euro/lekë për periudhën 2009 – 2015.

<sup>19</sup> Shpenzimet e jetesës së nënës e babait janë llogaritur në masën 100% të vlerës së pensionit.

<sup>20</sup> Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas ILDKPKI-së për dy persona.

lekë. Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhet në kushtet e nenit D/5 të Aneksit të Kushtetutës.

#### **6.9 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**6.10** Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Gjatë hetimit administrativ është sqaruar Komisioni se familja e tezes së subjektit të rivlerësimit, në pamundësi për të ndjekur administrimin e pronave të dhëna me qira, ka autorizuar shtetasen H. T. që të tërheqë cash në mënyrë periodike këto të ardhura, të cilat janë ruajtur në banesë. Në një moment kur u arrit një shumë e konsiderueshme parash nga mbledhja periodike e qirave, me kërkesë të tezes së subjektit, në vitin 2015, këto para janë depozituar në Raiffeisen Bank.*

*Deklaroj se shuma e depozituar në Raiffeisen Bank në vitin 2015 janë paratë e grumbulluara nga qiratë e dyqaneve – banesave dhe pronave të tjera të tezes dhe bashkëshortit të saj, ku nëna ime ka qenë e autorizuar për t'i tërhequr dhe ruajtur ato. Bashkëlidhur këtij prapësimi dorëzohet dokumentacioni provues<sup>21</sup>.*

*Këto para janë vendosur në bankë nga nëna ime në vitin 2015, kohë në të cilën ishin draftuar ligjet në kuadrin e Reformës në Drejtësi dhe kanë qëndruar në llogarinë e nënës deri në vitin 2019, fakt i cili tregon se unë nuk kam pasur asgjë për të fshehur. Këto para, përveç faktit që janë depozituar në bankë nga nëna, nuk janë përdorur kurrë as nga nëna, as nga unë dhe as nga ndonjë anëtar tjetër i familjes”.*

**6.11** Në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni i ka pranuar ato, duke mos e ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, edhe për faktin se të ardhurat nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit apo familjarët e tij (nëna/babai).

**7. Analiza financiare e përgjithshme për periudhën e rivlerësimit,** bazuar në dokumentacionin e disponuar, deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësimi i kryer për çdo pasuri nga trupi gjykues, rezultojnë përkatësisht:

- i) në vitin 2005, në balancë negative në vlerën -531.153 (pesëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, për krijimin e pasurisë automjet tip “\*\*\*”;
- ii) në vitin 2011, në balancë negative në vlerën -892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, për shlyerjen e kredisë në Raiffeisen Bank;
- iii) në vitin 2012, në vlerën -918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, për krijimin e pasurisë automjet tip “\*\*\*” në muajin shkurt dhe në vlerën -1.724.178 (një milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, për vlerën e investuar në krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, në muajin mars.

#### **Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u evidentuan problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë, nga ku rezultoi se ai ka kryer deklaratim të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë,

<sup>21</sup> Bashkëlidhur këtij prapësimi dorëzohet Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 26.6.2023 dhe Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.6.2023, si dhe paraqes edhe një prokurë të vitit 2018, në bazë të së cilës teza ime V. H., ka autorizuar nënën time për të tërhequr qiratë që ata përfitojnë nga pronat e tyre. Pavarësisht se kjo prokurë është e mëvonshme, provon faktin se nëna ime ka vepruar në emër dhe për llogari të motrës së saj, në kushtet kur ajo prej vitesh jeton në Itali.

pasi ka bërë deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e tyre.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**15.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim ka dërguar në datën 30.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Ndriçim Troplini.

**16.** Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit Ndriçim Troplini, si dhe deklasifikimin e tij. AKSIK-ja ka përcjellë në datën 28.2.2023 raportin e deklasifikuar plotësisht për prokurorin Ndriçim Troplini, për të cilin ka konstatuar përshtatshmëri për vijimin e detyrës. Komisioni nuk pati të dhëna për hetime të mëtejshme lidhur me subjektin e rivlerësimit, mbi kriterin e kontrollit të figurës.

### **Konkluzion për rubrikën e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**17.** Raporti i vlerësimit profesional është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, lidhur me 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe 3 dosjet e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

**18.** Lidhur me 5 dosjet e përzgjedhura me short, subjektit i`u kërkuan shpjegime për dosjen **nr.4** “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2013”, akt i datës 17.2.2014, si dhe procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2013, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**18.1** Në dosjen nr. 4 është konstatuar se në datën 20.2.2014, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë kontrollit të ushtruar në dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 26.6.2013, ka konstatuar zvarritje në fazën e veprimeve hetimore pas regjistrimit të procedimit penal, si dhe zvarritje dhe mungesë kontrolli nga ana e prokurorit deri në zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore. Ka rezultuar se veprimet hetimore dhe procedurale janë kryer nga prokurori vetëm në janar të vitit 2014.

**18.2** Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime lidhur me ecurinë e këtyre verifikimeve, konkluzionet përkatëse, si dhe nëse nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është marrë ndonjë masë ndaj tij në lidhje me konstatimin e zvarritjes së hetimeve, duke i vënë në dispozicion Komisionit aktet përkatëse.

**18.3** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar sa vijon:

*“Në lidhje me hetimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2013, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga data e regjistrimit të saj, 14.10.2013, deri në datën 14.11.2013, prej oficerit të policisë gjyqësore që ka pasur dosjen në hetim nuk janë kryer veprime hetimore dhe, për këtë arsye, ky oficer është zëvendësuar. Gjithashtu, edhe në kuadër të verifikimeve të këtij materiali kallëzues*

*vērehet se oficeri i policisë gjyqësore nuk ka kryer në kohë veprimet verifikuese të ngarkuara. Ndërsa, nga muaji janar 2014 deri më 17.2.2014, ku dosja ka vajtur në gjyq, e gjithë kjo periudhë kohore, siç jam shprehur edhe më lart, duke qenë se i pandehuri B. P. nuk gjendej në banesë, ishte larguar dhe nuk kishte një adresë se ku mund të ndodhej, është urdhëruar kërkimi i këtij personi, ku ka një korrespondencë të plotë me policinë gjyqësore në lidhje me rezultatet e kërkimit dhe mosgjetjes së këtij shtetasi. Nga verifikimet në dosje, mua më rezulton se ka një afat 3-mujor që nuk janë kryer veprime verifikuese dhe hetime në lidhje me këtë procedim penal, përkatësisht muajt shtator, tetor deri më 14 nëntor, ku oficeri i policisë gjyqësore është zëvendësuar. Në lidhje me faktin që drejtuesi i Prokurorisë i asaj kohe ka konstatuar zvarritje të hetimeve nga ana e prokurorit të çështjes, çmuj se një konkluzion i tillë është i gabuar. Dosja është hetuar dhe dërguar për gjykim për një periudhë kohore 4-mujore (nga data 14.10.2013, ku është regjistruar procedimi penal, deri në datën 17.2.2013, ku është dërguar për gjykim).*

*Është i vërtetë fakti që materiali kallëzues është mbajtur për një kohë të gjatë, rreth 2 muaj, për kryerjen e veprimeve verifikuese, por besoj që ky fakt ka ardhur për shkak të muajit gusht, që ka qenë leja vjetore, sikurse edhe për shkak të moskryerjes në kohë dhe dinamikë të veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore.*

*Në lidhje me pyetjen që a është marrë masë disiplinore nga ana e drejtuesit të Prokurorisë ndaj prokurorit në lidhje me këtë fakt, ju informoj se nuk është marrë masë disiplinore, pasi e gjithë dosja penale ka përfunduar për një periudhë 4-mujore, por nga ana e ish-drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, ky fakt është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tim profesional vjetor për vitin 2013 – 2014, ku jam vlerësuar me vlerësimin “Mirë”.*

**18.4** Sa më sipër, në vlerësim të dosjes hetimore të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se:

**a-** Në datën 14.10.2013, nga prokurori i çështjes Ndriçim Troplini është nxjerrë urdhri nr. \*\*\* “Për regjistrimin e procedimit penal”, për kallëzimin e kryer në datën 23.7.2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe është regjistruar edhe emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Me kryerjen e veprimeve hetimore është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore, M. V., i cili është zëvendësuar me vendimin nr. 14.11.2013, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të transferimit të tij pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

**b-** Me vendimin datë 14.1.2014 “Për zgjatjen e afatit të hetimeve”, prokurori Ndriçim Troplini vendos zgjatjen me 3 muaj të hetimeve.

**c-** Në datën 17.2.2014, prokurori ka marrë vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

**d-** Në zbatim të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale ishte detyra e prokurorit të merrte masa për kryerjen në kohë të veprimeve hetimore procedurale. Gjithashtu, në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 19.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për një ndryshim dhe një shtesë në Udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, urdhri “Për regjistrimin e procedimit penal” duhej të ishte nxjerrë brenda afatit 30-ditor nga regjistrimi i veprës penale.

**18.5** Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson sjelljet e subjtit të rivlerësimit të tilla që kanë sjell zvarritje në fazën e veprimeve hetimore pas regjistrimit të procedimit penal dhe mungesë kontrolli nga ana e tij, por se këto element në vetvete nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

## **TË DHËNAT ARKIVORE**

**19.** Lidhur me ankesat ndaj prokurorit Ndriçim Troplini, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, ka dërguar informacionin se për periudhën 2006 – 2020

rezulton se janë regjistruar disa praktika lidhur me ankesat. Komisioni pasi ka vlerësuar ato ka analizuar disa prej tyre, si vijon:

### **19.1 Ankesë nr. \*\*\*, viti 2017, e shtetasit V. V.**

**19.1.1** Lidhur me ankesat e shtetasit V. V., rezulton se ky shtetas ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe një sërë institucionesh të tjera ndaj shtetasve Ndriçim Troplini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Durrës dhe H. A., me detyrë oficer i policisë gjyqësore pranë kësaj Prokurorie, duke pretenduar dhe ngritur objeksione, kryesisht mbi:

- i) mënyrën e hetimit lidhur me procedimet penale nr. \*\*\*, viti 2010 dhe nr. \*\*\*, viti 2017, në të cilat ankuesi dhe djali i tij kanë qenë kallëzues;
- ii) mungesën e përgjigjeve ndaj kërkesave apo memorave të tij.

**19.1.2** Sipas shkresave të disponuara nga Prokuroria e Përgjithshme ka rezultuar se ankesat e shtetasit V. V. janë dërguar për kompetencë dhe zgjidhje ligjore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**19.1.3** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me shkaqet e pretenduara të zëvendësimit si prokuror lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2017.

**29.1.4** Në lidhje me hetimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur sqarimet e tij: *“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në kuadër të kallëzimit penal të shtetasit V. V., kundër shtetasve D. Xh. dhe A. B.. Prokurori Ndriçim Troplini ka vendosur moskompetencën e ndjekjes së këtij procedimi penal, duke ia dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, si prokuroria kompetente. Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë ka dërguar çështjen për zgjidhje të kompetencës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka vendosur se kompetente për hetimin e këtij procedimi penal është Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.*

*Shtetasi V. V. nuk ka qenë dakord me caktimin e subjektit Ndriçim Troplini, si prokuror i çështjes, duke kërkuar disa herë me ngulm zëvendësimin e tij nga hetimi i këtij procedimi penal, pasi prokurori ndodhej në kushtet e neneve 15, 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale. Duke u gjendur para këtij fakti, prokurori Ndriçim Troplini ka çmuar se ekzistojnë shkaqe objektive që e pengojnë në hetimin e këtij procedimi penal dhe, për këtë arsye, bazuar në nenet 26 dhe 17, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar heqje dorë nga hetimi i procedimit penal nr. \*\*\*. Drejtuesi i Prokurorisë gjithashtu ka çmuar zëvendësimin e prokurorit Ndriçim Troplini në hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017, me një prokuror tjetër”.*

**19.1.5** Trupi gjykues i Komisionit vëren se zëvendësimi i subjektit të rivlerësimit nga hetimi i çështjes, është bërë me kërkesën e tij, sipas neneve 17, 26 dhe 27/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Ankuesi ka paraqitur ankesë edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2023, ka vendosur arkivimin e saj, me arsyetimin se ankesa nuk i përket natyrës disiplinore.

**19.1.6** Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se, bazuar në nenin 26/1 dhe nenin 17 të K.Pr. Penale si dhe në zbatim të nenit 5/c, të Urdhrit nr. 141, datë 19.06.2014 "Per miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokuroreve", **prokurori në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tij, duhet që të jetë i paanshëm, të duket që është i paanshëm si dhe të perceptohet që është i paanshëm.** Për arsyet më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, porë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e rrethanave të përmendura më sipër, por se këto element në vetvete nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.



## **19.2 Ankesë nr. \*\*\*, viti 2020, e shtetasve A. H.**

**19.2.1** Lidhur me ankesën e shtetasve A. H., rezulton se kjo shtetase ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucione të tjera ndaj prokurorit Ndriçim Troplini, duke pretenduar dhe ngritur objeksione, kryesisht mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga prokurori, konkretisht të kallëzimit të paraqitur prej saj për shtetasit A. R. dhe L. R. e favorizimin e personave të mësipërm.

**19.2.2** Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020, të Prokurorisë së Përgjithshme, ka rezultuar se ankesa e shtetasve A. H. është dërguar për kompetencë dhe zgjidhje ligjore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**19.2.3** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me çështjet e pretenduara nga denoncuesja A. H., sa i përket kallëzimit penal të paraqitur prej saj ndaj shtetasve A. e L. R.

**19.2.4** Subjekti i rivlerësimit sqaron:

*“Në datën 24.11.2016 shtetasja A. R. (H.), banore e Lagjes nr. \*\*\*, Durrës, është paraqitur para oficerëve të policisë gjyqësore, duke bërë kallëzim penal. Bazuar në nenin 290/1, shkronjat “d” dhe “e”, si dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 9.12.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*. Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kallëzuesja A. R. (H.). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka shqyrtuar kërkesën e shtetasve A. R. (H.), me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 10.2.2017, ka vendosur të mos e pranojë kërkesën e kësaj shtetaseje, duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës shtetasja A. R. (H.). Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 10.10.2017, ka vendosur shfuqizimin e vendimit datë 14.12.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, “Për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016”, duke urdhëruar organin e akuzës të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetime të mëtejshme.*

*Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Durrës arsyeton se vendimi i prokurorit duhet të shfuqizohet, duke u urdhëruar regjistrimi i procedimit penal dhe vijimi i hetimeve sipas drejttimeve të përcaktuara prej saj.*

*Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*. Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes Ndriçim Troplini, pasi ka njoftuar akuzën, ka dërguar për gjykim të pandehurit A. R., për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, si dhe ka kërkuar në gjykatë që i pandehuri A. R. të deklarohej fajtor dhe të dënohej për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.*

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.6.2019, ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. R., për veprën penale “përdorim të dokumenteve të falsifikuara””, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Kundër vendimit të gjykatës, prokurori i çështjes ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, por kjo Gjykatë ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

*Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka konkluduar se ajo nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë, sipas parashikimeve të nenit 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe, për këtë arsye, ka vendosur arkivimin e saj.”*

**19.2.5** Trupi gjykues i Komisionit vëren se sa i përket veprimtarisë vendimmarrëse dhe kryerjes së veprimeve hetimore në funksion të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal, qëndrojnë konstatimet e dhëna nga gjykata e se prokurori ka

shmangur kryerjen e një sër veprimesh hetimore për zgjidhjen e çështjes. Kjo situatë gjen shpjegim edhe me veprimet e kryera prej tij në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.10.2017, ku në përfundim të hetimeve ka dërguar çështjen për gjykim. Pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit në vlerësimin e themelit të çështjes, vlerësojmë se konstatimet lidhur me këtë rast nuk janë të tilla për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

### **19.3 Ankesë Nr. \*\*\* e vitit 2020, e shtetasit B. M.**

**19.3.1** Lidhur me ankesën e shtetasit B. M. rezulton se ky shtetas ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucione të tjera ndaj prokurorit Ndriçim Troplini duke pretenduar dhe ngritur objeksione kryesisht mbi mënyrën e hetimit dhe vlerësimit të çështjes dhe marrjes së provave.

**19.3.2** Sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. \*\*\*, datë 31.03.2020, ka rezultuar se ankesa e shtetasit B. M. është dërguar për kompetencë në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë Tiranë. Me vendimin nr. \*\*\* Prot., datë 14.11.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së ankuesit z. B. M. me nr. \*\*\* Prot., datë 02.04.2020, për pretendimet e ngritura ndaj magjistratit z. Ndriçim Troplini, prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe për një pjesë të pretendimeve të ngritura ndaj magjistrates znj. E. Xh., prokurore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**19.3.3** Në lidhje me ankesën e shtetasit B. M., subjekti i rivlerësimit informon se ky shtetas është paraqitur në gjykatë si i pandehur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke u akuzuar për veprat penale të “Mashttrimit” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal si dhe për veprën penale të “Shpërdorimit të kompetencave”, parashikuar nga neni 164 të Kodit Penal, duke u deklaruar fajtor nga gjykata për të dyja keto akuza.

Në përfundim trupi gjykues i Komisionit i konsideron shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit të bazuara në provat e administruara.

### **19.4 Ankesë nr. \*\*\*, viti 2018, e shtetas M. D.**

**19.4.1** Lidhur me ankesën e shtetas M. D., rezulton se kjo shtetase ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit Ndriçim Troplini, duke pretenduar dhe ngritur objeksione, kryesisht mbi mosmarrjen në konsideratë të kërkesave të ankueses gjatë procesit të hetimit.

**19.4.2** Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, ka rezultuar se ankesa e shtetas M. D. është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**19.4.3** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me ecurinë e këtyre ankesave, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës lidhur me vendimmarrjen e organeve kompetente.

**19.4.4** Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.10.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës, është urdhëruar që të rifillojë hetimet për procedimin penal nr. \*\*\*, datë 20.10.2017, në lidhje me veprat penale “falsifikim dokumentesh” dhe “mashttrim”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 143 të Kodit Penal. Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe detyrave të lëna nga kjo gjykatë, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Durrës është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.10.2017. Prokuror i çështjes është caktuar Ndriçim Troplini. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit (prokurori i çështjes) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.11.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 20.10.2017. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasja M. D. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.1.2019, ka*

*vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 23.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

**19.4.5** Trupi gjykues i Komisionit, i konsideron shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit të bazuara në provat e administruara.

**19.5** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2020, ka dërguar informacion se ndaj z. Ndriçim Troplini është dërguar në këtë Prokurori një ankesë, e cila është vlerësuar të dërgohet për kompetencë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**19.5.1** Pas verifikimit të regjistrimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezulton që në emër të z. Ndriçim Troplini të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

**19.5.2** Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2020, e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar drejtuar Prokurorisë së Rrethit Durrës, rezulton se ankimi është paraqitur nga shtetasi H. B. Në ankim është pretenduar se nga prokurori Ndriçim Troplini nuk i është kthyer përgjigje dhe nuk është njohur me rezultatet e hetimeve të kryera.

**19.5.3** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me ecurinë e këtyre ankesave, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës lidhur me vendimmarrjen e organeve kompetente.

**19.5.4** Në lidhje me ankesën e paraqitur nga shtetasi H. B., subjekti i rivlerësimit sqaron se *ky shtetas, banor i qytetit të Durrësit, ka bërë kallëzim penal ndaj përmbaruesit gjyqësor, shtetasit P. C., për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në kallëzim, ky shtetas pretendon se me Kontratën e Huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.5.2008, i ka dhënë hua shtetasit B. G. vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, si dhe interesa me 8% të vlerës. Në kushtet kur kjo vlerë nuk i është kthyer nga shtetasi B. G., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe është pajisur me urdhrin e ekzekutimit nr. \*\*\*, datë 28.3.2012. Në lidhje me këtë procedim, subjekti i rivlerësimit ka administruar pranë Zyrës Përmbarimore Durrës dosjen përmbarimore, sikurse janë administruar edhe vendimet gjyqësore që kanë shpallur të pavlefshme veprimet përmbarimore. Subjekti i rivlerësimit shprehet se nga analiza e fakteve objekt procedimi, duke analizuar me kujdes provat e grumbulluara gjatë hetimit, ka krijuar bindjen se përmbaruesi gjyqësor P. C. ka shkelur ligjin, duke shpërdoruar detyrën. Subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. \*\*\*, të filluar në datën 7.5.2019, me të pandehur përmbaruesin gjyqësor P. C., si dhe duke i dhënë statusin e viktimës të veprës penale shtetasit H. B. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pas shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar të pafajshëm përmbaruesin P. C. Duke mos qenë dakord me vendimin e gjykatës, prokurori Ndriçim Troplini deklaroi se ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Durrës.*

**19.5.5** Komisioni vëren se në datën 4.4.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka bërë kallëzim penal shtetasi H. B. ndaj përmbaruesit gjyqësor P. C. Procedimi penal është regjistruar me nr. \*\*\*, në datën 7.5.2019, me të pandehur përmbaruesin gjyqësor P. C. Në datën 20.5.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kërkesën për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2019, në ngarkim të të pandehurit P. C., akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2020, ka vendosur pushimin e çështjes penale, që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, datë 7.5.2019, në ngarkim të të pandehurit P. C., për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

**19.5.6** Ankuesi H. B. i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020, për shkak të zgjatjes së hetimeve për 1 vit nga ana e organit të akuzës, ankesë e cila është arkivuar, me arsyetimin se nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë, në kuptim të

nenit 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**19.5.7** Lidhur me ankesën e shtetasit H. B., për zgjatjen prej 1 viti të afatit të përfundimit të hetimeve, vlerësojmë se ky afat është parashikuar nga neni 324 i Kodit të Procedurës Penale, në kuptim të pavarësisë së organit të akuzës gjatë veprimtarisë së tij. Ligji ka parashikuar gjithashtu se kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve i pandehuri dhe viktimat kanë të drejtën e ankimit brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit (neni 325/1 i Kodit të Procedurës Penale).

**19.5.8** Për arsyet më sipër, trupi gjykues i Komisionit, i vlerëson shpjegimet e subjektit të rivlerësimit të bazuara.

## DENONCIME

**20.** Në Komision janë paraqitur 29 denoncime, 8 prej të cilave janë bërë nga i njëjti denoncues. Nga verifikimi i denoncimeve janë analizuar ato të cilat kanë rezultuar se kanë pasur të dhëna, të tilla që mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

**20.1 Denoncim i shtetasit S. T.** (bashkim i 8 denoncimeve<sup>22</sup>), me objekt “Denoncim i subjektit të rivlerësimit dhe i disa prokurorëve dhe gjyqtarëve për korrupsion dhe falsifikim dokumentesh”. Në një prej denoncimeve, denoncuesi pretendon se prokurori Ndriçim Troplini nuk ka shqyrtuar të gjitha provat dhe sipas tij ka mungesë hetimi të kallëzimit të tij dhe zvarritje të hetimeve, për aq kohë sa pas 10 muajsh në fazën e hetimeve paraprake Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas denoncuesit, nga ana e prokurorit nuk është quajtur vepër penale falsifikimi i dokumenteve.

**20.1.1** Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi<sup>23</sup> informacion dhe kopje dokumentacioni nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Rezulton se materiali hetimor nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, është hetuar nga prokurori Ndriçim Troplini, i cili në datën 30.7.2017 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se: *“Në rastin konkret ndodhemi përpara një konflikti civil dhe pretendimet e palëve se, për pasurinë prej 500 m<sup>2</sup> truall janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren dokumente të falsifikuara, mund t’i paraqesin në gjykimin civil”*.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kallëzuesi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.10.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të mosfillimit, me arsyetimin se: *“Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe nuk janë verifikuar të gjitha pretendimet e ankuesit S. T.”*.

Prokurori i çështjes ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**20.1.2** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 22.1.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, çështje e ndjekur nga prokurorja O.R., e cila në datën 21.11.2018, pas përfundimit të hetimeve, ka shpallur moskompetencë tokësore për këtë procedim, për shkak se gjatë hetimeve dokumentet e pretenduara si të falsifikuara nga shtetasi S. T. janë lëshuar nga Bashkia Tiranë. Në zbatim të nenit 76, paragrafët 1 dhe 3 dhe neni 84 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe për shkak se gjatë hetimit u provua se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë po hetohej procedimi penal nr. \*\*\*, datë 13.3.2017, për të njëjtën vepër penale dhe me kallëzues shtetasin S. T., çështja është transferuar së bashku me aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga prokurorja O.R.

<sup>22</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017, nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2018, nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019, nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019, nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2021.

<sup>23</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2023, në dosjen e denoncimeve.

**20.1.3** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se vendimmarrja e prokurorit për mosfillimin e procedimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, është marr në ditë pushimi, e në tejkalim të afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Veprimet hetimore të kryera prej tij duket se janë të paplota.

**20.1.4** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në prapsimet e tij: *“Në lidhje me veprimet procedurale të ndjekura prej tij, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në bazë të procesverbaleve të datave 18.7.2017 dhe 25.7.2017 “Për këqyrjen e marrjen e provës” janë administruar një sërë provash shkresore, të cilat i shërbejnë procesit gjyqësor civil, për të provuar pretendimet e kallëzuesit S. T. si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit I. T., krahas trashëgimtarëve të tjerë ligjorë. Gjithashtu, edhe zgjidhja e çështjes së pronësisë së truallit prej 500 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, është një çështje e karakterit civil, ku palët ndodhen në gjyq në Gjykatën e Apelit Durrës. Në analizë të fakteve të sipërcituara, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal.*

*Lidhur me tejkalimin e afatit të vendimmarrjes sime nga 15 ditë në 17 ditë, për mosfillimin e këtij procedimi penal, është kryer para se ky ligj të hynte në fuqi, para se të sanksionohet në ligj afati 15-ditor.*

*Nëse data 30.7.2017 korrespondon ditë e diel, ju garantoj se për shkak të natyrës dhe ngarkesës së punës më duhet të dal të punoj edhe në ditët që janë pushim”.*

**20.1.5** Sa më lart, në lidhje me veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë procedim, është e rëndësishme të theksohet se veprimet e kryera prej organit të akuzës janë objekt kontrolli i gjykatave. Në këtë rast, rezulton se Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke legjitimuar faktin se vendimi për mosfillimin e procedimit penal nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe nuk janë verifikuar të gjitha pretendimet e ankuesit. Pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit në vlerësimin e themelit të çështjes, vlerësojmë se moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe shteruese duket se ka çuar në një zgjidhje të ndryshme të çështjes objekt hetimi duke shtuar edhe vonesa në zgjidhjen e saj, situata të cilat duhet të ishin shmangur nga subjekti i rivlerësimit.

**20.2 Denoncim i shtetasit B. D.**<sup>24</sup> (2 denoncime), me objekt “Denoncim/ankim ndaj subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini për korrupsion dhe zvarritje hetimesh”. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, edhe pse është i zhytur në korrupsion, vendosi mosfillimin e procedimit penal, duke mos çuar inspektorin A. H. për gjykim themeli.

**20.2.1** Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi t’i vihen në dispozicion dosja gjyqësore nr. (\*\*\*)\*\*\*, datë 11.2.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, aktet përkatëse lidhur me procedimin penal nr. \*\*\* kallëzimi, datë 8.11.2018, si dhe aktet e përgatitura nga prokurori i çështjes. Në vijim, Komisioni kërkoi gjithashtu informacion<sup>25</sup> nëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë regjistruar materiale/procedime penale ku përmendet shtetasi A. H., nëse po, cilët ishin prokurorët, duke kërkuar edhe aktet e përgatitura nga Prokuroria. Nga vlerësimi i akteve rezultoi se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka përcjellë<sup>26</sup> kopje të dosjes gjyqësore, që i përket vendimit nr. (\*\*\*)\*\*\*, datë 11.2.2019. Nga shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion, rezulton se:

- a) Në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini, bazuar në nenin 290, shkronja “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 15.11.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

<sup>24</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2020, ankim nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2019.

<sup>25</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, tek dosja e denoncimeve.

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023, tek dosja e denoncimeve.

- b) Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Prishja e vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 15.11.2018, të Prokurorisë së Rrethit Durrës dhe urdhërimi për fillimin e procedimit dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme”, e cila, në përfundim të hetimit, ka vendosur<sup>27</sup> mospranimin e kërkesës së shtetasit B. D. dhe lënien në fuqi të vendimit për mosfillimin e procedimit penal.
- c) Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 20.2.2019, shtetasi B. D. ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.4.2019, ka pranuar<sup>28</sup> ankimin e kallëzuesit, duke vendosur “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, shfuqizimin e vendimit datë 15.11.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 6.11.2018” dhe urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal”, me arsyetimin se prokurori nuk mund të kryejë veprime hetimore që synojnë marrjen e provave nëse më parë nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale veprën për të cilën po kryhen hetime. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se prokurori ka gabuar në qëndrimin e tij dhe në veprimet procedurale të kryera.
- ç) Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, materiali kallëzues është regjistruar si procedim penal me nr. \*\*\*, datë 30.4.2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- d) Gjatë hetimit të këtij procedimi, subjekti ka shtyrë afatin e hetimeve për periudhën 31.12.2018 – 1.4.2020, për arsye se është e nevojshme edhe pyetja e shtetasit A. H. për hetimin e këtij procedimi penal. Hetimet janë shtyrë nga subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini, përkatësisht për periudhat 31.12.2018 – 30.3.2019, 31.3.2019 – 30.6.2019, 1.7.2019 – 1.10.2019, 1.10.2019 – 1.1.2020 dhe 1.1.2020 – 1.4.2020.
- dh) Në datën 31.1.2020, prokurori Ndriçim Troplini është zëvendësuar me një prokuror tjetër, pasi ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes.
- e) Në datën 18.2.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka marrë vendimin “Për bashkimin e procedimeve” dhe procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, është bashkuar me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018, duke i regjistruar në një procedim të vetëm me nr. \*\*\*.

**20.2.2** Duket se prokurori Ndriçim Troplini ka gabuar në qëndrimin e tij dhe në veprimet procedurale të kryera, pasi ai nuk mund të kryejë veprime hetimore që synojnë marrjen e provave, nëse më parë nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale veprën për të cilën po kryhen hetime. Nga vlerësimi i dosjes duket se ka zvarritje të pajustificuara të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit, edhe pas kthimit të saj nga Gjykata e Apelit për plotësime.

**20.2.3** Nga informacioni që Komisioni ka marrë<sup>29</sup> në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se për shtetasin A. H. janë regjistruar materiale/procedime penale ku ai përmendet, të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Ndriçim Troplini, si vijon:

- a) materiali kallëzues nr. \*\*\*, datë 18.7.2018 (bashkuar me materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 23.7.2018), marrë vendimi i mosfillimit në datën 31.7.2018 nga prokurori Ndriçim Troplini;
- b) materiali kallëzues nr. \*\*\*, datë 7.1.2020, marrë vendimi i mosfillimit datë 22.1.2020 nga prokurori Ndriçim Troplini.

<sup>27</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 11.2.2019.

<sup>28</sup> Ndër të tjera, arsyetohet se, së pari vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i paarsyetuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim. Prokurori nuk mund të kryejë veprime hetimore që synojnë marrjen e provave nëse më parë nuk ka regjistruar procedim penal. Gjykata e Apelit Durrës e gjen të gabuar vendimmarrjen e prokurorit, e cila nuk është si rrjedhojë e një hetimi të plotë të kallëzimit penal.

<sup>29</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, në dosjen e hetimit.

**20.2.4** Në lidhje me shtetasin A. H., Komisioni e ka pyetur disa herë subjektin e rivlerësimit nëse ka trajtuar çështje me këtë shtetas, nisur edhe nga fakti se ai vetë kishte deklaruar më herët (në pyetësorin standard) se kishte udhëtuar me këtë shtetas jashtë vendit (lidhje miqësore).

Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë përgjigje të qartë në pyetësorin e parë dhe prandaj është pyetur përsëri, ku sërish deklaroi në pyetësorin e datës 21.2.2023 se nuk ka hetuar material kallëzues apo procedim penal që ky shtetas të ketë qenë person i dyshuar apo person ndaj të cilit zhvillohen hetime për kryerjen e ndonjë vepre penale.

**20.2.5** Nga hetimi i Komisionit në dokumentin “Raporti i hyrje - daljeve në territorin shqiptar për shtetasin Ndriçim M. Troplini<sup>30</sup>” (TIMS), rezulton se në harkun kohor 6.2.2010 – 9.2.2010 subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar në shtetin grek së bashku me shtetasin A. H. (kanë dalë nga territori shqiptar nga pika kufitare Kakavijë, në datën 6.2.2010, ora 08:06:35’ dhe kanë hyrë në territorin shqiptar po nga pika kufitare Kakavijë, në datën 9.2.2010, ora 04:40:50’). Udhëtimi është bërë me automjetin me targë \*\*\*, në pronësi të shtetasit A. H. Këtë fakt subjekti e vetëdeklaroi edhe në përgjigjen e pyetësorit standard (datë 11.3.2021).

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në zbatim të nenit 26, pika 1 dhe shkronjës “ë” të pikës 1 të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në zbatim të neneve 3 dhe 5 të vendimit nr. 32, datë 24.2.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit”, subjekti duhet të kishte hequr dorë nga hetimi, ku përfshihej shtetasi A. H., për arsye njëanësie (njohja me shtetasin A. H.).

Duket se shqyrtimi i materialit kallëzues nr. \*\*\*, datë 18.7.2018 (bashkuar me materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 23.7.2018), marrë vendimi i mosfillimit në datën 31.7.2018, nga prokurori Ndriçim Troplini, i rihapur dhe vijuar më tej hetimet nga prokurorë të tjerë, përbëjnë një sjellje njëanshmërie të dukshme në qëndrimet e subjektit të rivlerësimit dhe zgjidhjen e çështjes.

**20.2.6 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.**

**20.2.7** Në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit, pasi ka cilësuar gjerësisht faktet dhe veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimeve penale me ankues shtetasin B. D., në përfundim ka deklaruar se *referuar shtetasit A. H. nuk ka hetuar asnjë material kallëzues apo procedim penal që ky shtetas të ketë qenë person i dyshuar apo person ndaj të cilit zhvillohen hetime për kryerjen e ndonjë vepre penale. Duke qenë se shtetasi A. H. ka qenë me detyrë drejtues i IMT-së Durrës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës mbërrinin çdo ditë materiale kallëzuese, si nga ana e këtij institucioni kundër shtetasve të ndryshëm për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, ashtu edhe nga ana e personave të ndryshëm që ankoheshin në lidhje me prishjen e ndërtimeve pa leje.*

*Subjekti parashtron se nuk ka konflikt interesi dhe as shkak njëanësie për të hequr dorë nga shqyrtimi i një materiali kallëzues apo procedimi penal, derisa rezulton se veprimtaria e institucionit të IMT-së Durrës, me drejtues shtetasin A. H., ka qenë në përputhje dhe në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore.*

**20.2.8** Trupi gjykues i Komisionit vëren se, bazuar në nenet 26/1 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në zbatim të nenit 5/c të Urdhrit nr. 141, datë 19.6.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, *prokurori, në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tij duhet që të jetë i paanshëm, të duket që është i paanshëm, si dhe të perceptohet që është i paanshëm.* Për arsyet më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, porë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e rrethanave të përmendura

<sup>30</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2022, të DPPSH-së, në dosjen e hetimit.

më sipër. Trupi gjykues vlerëson se situata të cilat duhet të ishin shmangur nga subjekti i rivlerësimit, pasi ato duket sikur kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes.

**20.3 Denoncim i shtetas A. M.**, me objekt “Denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini”, pasi nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të pafajësisë për shtetasin S. H.

**20.3.1** Nga vlerësimi i dokumentacionit ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesë të prokurorisë ka marrë për shqyrtim aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “shpërdorim detyre” dhe pushimin e procedimit për veprën penale “falsifikim dokumentesh”. Kjo gjykatë, në vendimin nr. (\*\*\*)\*\*\*, datë 28.7.2021, me prokuror subjektin e rivlerësimit Ndriçim Troplini, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të shtetasit S. H. dhe pushimin e procedimit penal.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim viktima A. M. pranë Gjykatës së Apelit Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.3.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit të denoncueses, si ankim i bërë nga një person i palegjitimuar, në kuptim të shkronjës “a” të nenit 420 dhe të nenit 422 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Ndriçim Troplini, nuk ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi.

**20.3.2** Në interpretim të nenit 148 të Kushtetutës, prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, si organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit. Referuar nenit 422 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori, i pandehuri, kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

**20.3.3** Komisioni vlerëson se nga subjekti i rivlerësimit nuk është ushtruar e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, si një e drejtë e njohur nga ligji, në kuptim të neneve 407 dhe 408 të Kodit të Procedurës Penale.

**20.3.4** Në lidhje me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit parashtron se:

*“Në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka çmuar se pasi debitorja ka shlyer vlerën e debisë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, që i detyrohej kreditorit, përmbaruesi gjyqësor duhet të ndërpriste procedurat e ankandit të shitjes së pasurisë, pasi ishte likuiduar pjesa e debisë. Duke mos ndërprerë procedurat e ankandit pas shlyerjes së kredisë, ky shtetas ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e rregullt të detyrës së përmbaruesit. Ndërkohë, përveç të pandehurit që ka pretenduar se procedurat përmbarimore duhet të vazhdonin, pasi nuk është shlyer e gjithë shuma e debisë sepse është paguar vetëm pjesa kryesore e saj, por nuk janë paguar tarifat e shërbimit përmbarimor dhe gjyqësor për një periudhë që ka zgjatur 7 vjet, një fakt të tillë ka përkrahur edhe gjykata në shqyrtimin e padive midis palëve në lidhje me këtë procedurë përmbarimore. Subjekti ka shpjeguar se: “Pasi kam marrë të zbardhur vendimin e gjykatës dhe jam ulur duke analizuar zë për zë të gjitha faktet e provat, si dhe analizën e tyre që ka përdorur gjykata në dhënien e pafajësisë ndaj të pandehurit S. H., qëndrimi im në lidhje me kundërshtimin e këtij vendimi gjyqësor, duke ushtruar të drejtën e ankimit, ka qenë i dyzuar.*

*Gjatë kësaj periudhe kohore që duhej të bëja ankimin, kam marrë një informacion, ku më rezultonte se shtetasja A. M. shumë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, të cilën e ka depozituar në bankë me qëllim shlyerjen e debisë ndaj kreditorit, për të cilën ka deklaruar se ia ka dhuruar vjehrra e saj, shtetasja F. A., në të vërtetë këtë shumë parash A. dhe bashkëshorti i saj, shtetasi B. A., ia kishin marrë nëpërmjet vjedhjes dhe mashtrimit shtetas F. A.*

*Në lidhje me këtë fakt, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2022, për veprën penale “vjedhje me anë të mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar në bazë të kallëzimit të shtetas F. A. kundër bashkëshortëve A. M. dhe B. A., ku kjo shtetase pretendon se shtetasit e mësipërm i kanë vjedhur me anë të mashtrimit një shumë të konsiderueshme parash, të cilat i kanë përdorur për shlyerjen e debisë në procedurat përmbarimore të sipërcituara.*



*Marrja e këtij informacioni më ka shtyrë drejt marrjes së vendimit për të mos ushtruar të drejtën e ankimit në lidhje me këtë rast”.*

**20.3.5** Trupi gjykues i Komisionit në vlerësim të situatës faktike vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë shteruese. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2022, nuk mund të përbëjë shkak të arsyeshëm për të ndryshuar bindjen e brendshme të prokurorit për të mos ushtruar ankim kundër Vendimit nr. \*\*\*, datë 28.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak se procedimi penal është regjistruar pasi ka kaluar afati i ankimit kundër vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 28.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në kuptim të nenit 415 të Kodit të Procedurës Penale.

Për arsyet më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, porë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e rrethanave të përmendura më sipër, por se këto element në vetvete nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

**20.4** Sipas disa informacioneve<sup>31</sup> të marra nga burime të hapura, ka rezultuar se në një çështje penale për vrasje, prokurori çështjes ka qënë zoti Ndririm Troplini, konkretisht vrasja e shtetasit *E. D. në zonën e \*\*\**. Lidhur me këtë çështje, Komisioni i është referuar kryesisht informacioneve të hapura (portale/media), [https://shqiptarja.com/\\*\\*\\*,](https://shqiptarja.com/***,) korrespondencës me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorëve të dërguar gjatë hetimit, si dhe disa verikimet institucionale.

**20.4.1** Komisioni ka verifikuar dokumentacionin lidhur me këtë çështje penale dhe nga vlerësimi i informacioneve ka rezultuar se:

- i) Procedimi penal nr. \*\*\*, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit *E. D.*, ka pasur prokuror të çështjes z. Ndririm Troplini, i cili në datën 25.05.2015 ka vendosur pezullimin, duke dërguar çështjen për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.
- ii) Procedimi penal nr. \*\*\*, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit *F. D. (nëna)*, është ndjekur dhe drejtuar nga një prokuror tjetër në Prokurorinë e Rrethit Durrës dhe në datën 4.5.2015 është vendosur pezullimi, duke dërguar çështjen për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

**20.4.2** Nga vlerësimi i fakteve të mbledhura gjatë hetimit ka rezultuar se gjatë hetimeve të kryera nga prokurori Ndririm Troplini mbi procedimin penal nr. \*\*\*), është konsideruar shtetasi *F. Q.* si i dyshuar për veprën penale “vrasje”, por emri i tij nuk është regjistruar në regjistrin e veprave penale, duke e lënë këtë vepër pa autor, megjithëse duket se prokurori ka pasur dyshime të forta ndaj këtij shtetasi, si dhe ka kryer edhe eksperimentin shkencor.

Gjatë veprimeve hetimore është dërguar një letërporosi në Kosovë, por nuk është pritur përgjigja e saj, pasi është vendosur pezullimi i hetimeve. Në dosje nuk rezultojnë veprime për përditësim apo informacion mbi përgjigjen e kërkuar apo komunikime të mëvonshme me Ministrinë e Drejtësisë për këtë letërporosi.

Prokurori çështjes z. Ndririm Troplini, në datën 25.05.2015, (rreth tre vite hetime) ka vendosur pezullimin e çështjes penale si pa autor.

**20.4.3** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.06.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës dosjen penale nr. \*\*\*, viti 2012, e përbërë nga 4 fashikuj, së bashku me provat materiale.

**24.4.4** Duket sikur këto dy procedime penale, edhe pse nga aktet e prokurorëve duket se kishin një autor të dyshuar të përbashkët, edhe pse nuk u bashkuan gjatë hetimeve, kanë pasur një sinkronizim në fund, duke vendosur pezullimin në të njëjtën kohë dhe dërgimin e tyre

---

<sup>31</sup> [https://shqiptarja.com/\\*\\*\\*,](https://shqiptarja.com/***,)

në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës. Kjo praktikë është bërë me shkresë përcjellëse të drejtuesit të Prokurorisë.

**20.4.5** Mosveprimet duket se çuan në mbylljen e kësaj çështjeje. Nisur edhe nga të dhëna ose fakte publike, duket se dosjet janë lënë qëllimisht pa autor, çështjet nuk janë bashkuar gjatë hetimeve, megjithëse kishte të dhëna publike se është vrarë nëna 60-vjeçare e një trafikanti të ekzekutuar, pezullimi i tyre, megjithëse të ndara, është vendosur në të njëjtën kohë, duke u përcjellë përfundimisht së bashku në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës.

**20.4.6** Në përfundim të verifikimeve, nisur edhe nga fakti se informacioni nga burime të hapura duken në pajtueshmëri të dukshme me veprimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, trupi gjykues ka vlerësuar se ky rast duhet trajtuar në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, e se ai bën pjesë në periudhën e rivlerësimit, për të cilin Komisioni po kryen këtë proces.

**20.4.7** Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit konstaton se tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve hetimore, ka sjellë mosndëshkimin e të akuzuarve dhe vepra të tjera penale vijuese, një rezultat dukshëm në cenim të imazhit të prokurorit tek sistemi i drejtësisë, e në moszbatim të legjislacionit procedural penal.

**20.4.8** Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

**20.4.9** Subjekti i rivlerësimit, pasi ka parashtruar<sup>32</sup> përpara Komisionit mbi veprimet hetimore të kryera prej tij lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, ka argumentuar sa vijon:

*“Për këtë procedim penal ai ka konsideruar shtetasin F. Q. si të dyshuar kryesor për veprën penale “vrasje”, por emri i tij nuk është regjistruar në regjistrin e veprave penale, duke e lënë këtë vepër pa autor. Bazuar në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit argumenton se regjistrimi i procedimit penal në regjistrin e procedimeve jo domosdoshmërisht përputhet me momentin e regjistrimit në regjistër të emrit të personit të dyshuar/autorit, që mund të ketë kryer veprën penale. Në kuptim të nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale, emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale gjendet nga hetimet e zhvilluara, të cilat zgjasin në kohë. Duke regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale në regjistër, fillon edhe afati procedural, brenda të cilit organi i akuzës duhet të vendosë mbi dërgimin e çështjes në gjykatë ose pushimin e procedimit penal. Plotësimi i afatit maksimal të hetimit nuk e lejon prokurorin të mbledhë prova të reja përtej këtij afati, sepse bazuar në nenin 324/5 të Kodit të Procedurës Penale, provat e marra në tejkallim të afatit nuk mund të përdoren.*

*Sa i përket faktit se procedimet penale që i përkasin veprës penale “vrasje” të shtetasve E. D. dhe F. D., nuk janë bashkuar në një të vetëm, subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk plotësoheshin kushtet penale në interpretim të nenit 79/1, shkronjave “b” dhe “c”, si dhe të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale.*

*Për arsyet si më sipër, në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, në referencë të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pezullimin e çështjes penale dhe dërgimin e fashikullit penal pranë policisë gjyqësore për veprime të mëtejshme.”*

**20.4.10** Referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, ai është shprehur se shtetasi F. Q. ka qenë një prej të dyshuarve për kryerjen e veprës penale “vrasje” të shtetasit E. D., madje për këtë ai ka kryer veprime procedurale dhe teknika speciale të hetimit. Subjekti i rivlerësimit shprehet se shtetasi F. Q. mund të ishte një nga autorët e veprës penale, por nuk ka pasur prova që t’i shërbenin prokurorit për të regjistruar emrin në regjistër e që ky shtetas të merrte statusin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Gjithashtu, subjekti shprehet se në zbatim të pikës 1

<sup>32</sup> Shihni materialin nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023.

të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale, personi nën hetim ka të njëjtat të drejta me të pandehurin.

**20.4.10** Trupi gjykues i Komisionit, në analizën e tij ka marr në konsideratë një vendim të dhënë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si dhe dispozitat përkatëse procedurale penale.

Konkretisht Vendimin unifikues nr.3, datë 27.9.2002, në të cilin Kolegji është shprehur se terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale për subjektet e veprave penale ndryshon nga fillimi i çështjes penale e deri në dërgimin e saj për gjykim. Emërtimi i autorëve të veprave penale fillon me termin “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287), “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308 etj.) dhe “i pandehur”, që ndeshet në shumë dispozita të tjera të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale këto emërtime i merr në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim. Termin “person të cilit i atribuohet vepra penale” e gjen në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, që bën pjesë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të Kodit, që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijani për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallëzuesi se është ose mund të jetë autor i veprës penale. *Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi “person të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, plus momenti procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe as me termin “i pandehur”.*

Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur mendohet se dihet se kush është autori i krimit, por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse vërtet personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i veprës penale, do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm dhe në përputhje me ligjin.

Neni 323/1 i Kodit të Procedurës Penale (viti 2014) parashikon se brenda 3 muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj.

Neni 326/1/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se, kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.

**20.4.11** Trupi gjykues i Komisionit, duke vlerësuar sa më sipër, pa dashur të hyjë në vlerësimin lidhur me themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit në këtë çështje, çmon se një kriter që duhet vlerësuar në këtë rast është aftësia e prokurorit për të marrë urdhra dhe vendime, bazuar në të dhënat e hetimit, provat e mbledhura e të kërkuara prej tij përgjatë hetimit, po ashtu edhe qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë. Vetë vendimmarrja e prokurorit në vetvete mbart paqartësi e dilema, si për sa i përket veprimeve hetimore (të kryera/moskryera), ashtu edhe vendimmarrjes së tij në raport me provat e administruara. Po ashtu, një element dukshëm në favor të arsyetimit se hetimet janë zvarritur, është edhe vlerësimi i provave, kohëzgjatja e veprimeve të kryera dhe marrja e vendimeve nga vetë prokurori, si për pyetjen e dëshmitarëve, ashtu edhe për vlerësimin e provave. Nga vëzhgimi i kronologjisë së veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim, nga tërësia e veprimeve dhe zgjidhja që iu dha çështjes në vitin 2015 krijohet bindja se me veprimet e tij prokurori ka zgjatur çështjen dhe nuk i ka dhënë asaj një zgjidhje, duke mos vënë para përgjegjësisë autorët e dyshuar.

Po ashtu, vendimmarrja e prokurorit Troplini në procedimin penal nr. \*\*\*, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit E. D., i cili ka vendosur në datën 25.5.2015 pezullimin, duke dërguar çështjen për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, e cila vjen menjëherë pas dërgimit të procedimit penal nr. \*\*\*, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit F. D. (nëna), dërguar gjithashtu për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në datën 4.5.2015, krijon perceptimin se veprimet kanë qenë të koordinuara dhe se qëllimi ishte shmangia e nxjerrjes para ligjit të autorëve të dyshuar.

**21.** Në përfundim, nga vlerësimi i rasteve lidhur me vlerësimin profesional dhe denoncimet, konstatohen mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por se konkluzionet e mësipërme nuk mjaftojnë gjithsesi për ta konsideruar subjektin e rivlerësimit të paaftë profesionalisht, por ato janë gjithashtu të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Mangësitë e konstatuara nga kontrolli i vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe denoncimet e çuan Komisionin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cënuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë në kuptim të nenit 61 pika 5 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ndriçim Troplini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 12.7.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Olsi KOMICI**

**Relatore**

**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore  
Jonida Vrana*